



This project is funded
by the European Union



Instituti i Organizatave Ndërkombëtare
te Shkencës Civile për të Promovuar
Mbrojtjen e Programit në Shqipëri

DORACAK PËR NDIKIMIN NË POLITIKAT E RUAJTJES SË NATYRËS PËRMES ADVOKIM-LOBIMIT EFEKTIV

Tiranë, Prill 2019

Për më shumë informacion:
www.inca-al.org/Advocacy

Adresa: Rruga Islam Alia,
Pallati IVEA, Kat 1,
Tirana, Albania.
Tel/Fax: +355 42231437
www.inca-al.org
e-mail: info@inca-al.org





This project is funded
by the European Union



Ministria e Mbrojtjes së Natyrës
dhe Planimit të Territorit dhe
Këmbimit të Tokës

DORACAK PËR NDIKIMIN NË POLITIKAT E RUAJTJES SË NATYRËS PËRMES ADVOKIM-LOBIMIT EFEKTIV





Thelimi i Organizatës Mbrojtëse
si Shqipërië Gjithë për të Përmirësuar
Menaxhin e Natyrës në Shqipërië

Publikuar nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipërië (INCA)

Rr. Islam Alla, pallati IVEA, kati i I-rë, Tiranë • Tel/faks: +355 42231437

Internet: <http://www.inca-al.org> • E-mail: info@inca-al.org

Copyright © Instituti për Ruajtjen e Natyrës - Shqipërië, 2019

Të gjitha të drejtat për publikimin, shumëfishimin, kopjimin, përdorimin e informacioneve të plota apo të pjesshme janë të rezervuara nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës - Shqipërië.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Hartimi i këtij dokumenti është udhëhequr nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipërië (INCA)

Unioni Ndërkombëtar i Ruajtjes së Natyrës (IUCN)

Kopje të këtij botimi mund t'i gjeni pranë:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipërië (INCA)

Rr. Islam Alla, pallati IVEA, kati i I-rë, Tiranë, Shqipërië

Tiranë, Prill 2019

Rreth Bashkimit Evropian

Bashkimi Evropian (BE) është i përbërë nga 28 vende anëtare, të cilët kanë vendosur që gradualisht të lidhin së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, gjatë një periudhe të zgjerimit në më shumë se 50 vitet e fundit, ata kanë ndërtuar një zonë stabilitetit, demokracie dhe zhvillimi të qëndrueshëm, duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale.

Bashkimi Evropian është i angazhuar për ndarjen e arritjeve të tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

Ky doracak u financua nga Bashkimi Evropian (Delegacioni në Shqipëri) dhe përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetë botuesit dhe nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Rreth INCA

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, INCA është një organizatë jo qeveritare, e ngritur në Qershor të vitit 2000, dhe e regjistruar si e tillë nga Gjykata e Tiranës në vitin 2004, me vendimin Nr. 1087. INCA ka zyrën e saj në Tiranë, por vepron në të gjithë territorin e Shqipërisë. INCA ka si qëllim kryesor të japë ndihmesën e saj në fushën e formimit profesional nëpërmjet trajnimeve dhe procesit të pjesëmarrjes, në ruajtjen e mjedisit, në mbrojtjen e vlerave natyrore dhe zhvillimin rajonal, mbrojtjen e florës dhe të faunës, vlerësimin e diversitetit biologjik, menaxhimin e zonave të mbrojtura, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe vendimmarrësve politik, dhe të ndërmarrë masa mbrojtëse kur është e mundur dhe e nevojshme për mbrojtjen e llojeve dhe habitateve të tyre kritike.

Detyra e Institutit është gjithashtu të integroje ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit me të gjitha çështjet e tjera ose fusha të shkencës që kanë një ndikim në burimet natyrore në vend. Instituti do të jete pjese e procesit të përmirësimit të legjislacionit dhe të problematikave të tjera të lidhura me ngritjen e kapaciteteve të institucioneve mjedisore Shqiptare, si dhe integrimin Evropian.

Rreth IUCN

IUCN, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, është organizata më e vjetër dhe më e madhe globale e mjedisit në botë, me mbi 1,200 anëtarë të qeverive dhe OJQ-ve dhe pothuajse 11,000 ekspertë vullnetarë në 160 vende. Rajoni Evropian i IUCN mbulon kontinentin Evropian, Rusinë dhe Azinë Qendrore dhe përfshin entitetet jashtë Bashkimit Evropian. Zyra e Programit IUCN për Evropën Juglindore (IUCN SEE) promovon përmirësimin e qeverisjes së burimeve natyrore dhe biodiversitetit dhe mbështet iniciativat për ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e ekosistemeve për mirëqenien njerëzore. Duke punuar ngushtë me Anëtarët dhe Komisionet e IUCN, ajo formon politikën rajonale dhe mbështet dy iniciativa kryesore: Iniciativa e Harkut Dinarik dhe Brezin e Gjelbër Evropian.

Parathënie

OSHC-të shihen si forca lëvizëse për transformimin e shoqërisë. Disa OShC-të kanë potencial të mirë për të zhvilluar dhe për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Megjithatë, për t'u përfshirë vërtet në hartimin e politikave të ruajtjes së natyrës, OShC-të duhet të rritin më tej kapacitetet dhe burimet e tyre. Ekzistojnë fusha sektoriale që nuk lidhen drejtpërdrejt me ruajtjen e biodiversitetit, të cilat mund të kenë ndikim të mundshëm edhe në ruajtjen e natyrës.

Udhëzimet e publikuara, nga Bashkimi Ndërkombëtar i Ruajtjes së Natyrës (IUCN), synojnë të ndihmojnë stafin dhe ekspertët e OShC-ve në angazhimin e tyre efektiv në përpjekjet kombëtare e lokale të ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit dhe t'u ofrojnë atyre një mjet për dhënien e njohurive anëtarëve të tyre. OShC-të duhet të luajnë një rol aktiv dhe efektiv në planifikimin dhe zbatimin e masave të ruajtjes së natyrës dhe angazhimin e palëve të tjera të interesit për vendimmarrje koherente. Gjithashtu, udhëzimet synojnë të ndihmojnë OShC-të që të rrisin kuptimin e legjislacionit të BE-së për fushën e ruajtjes së natyrës dhe rolin që ata mund të luajnë në zbatimin e tij.

OSHC-të, duhet të formësojnë një mesazh bindës mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës, të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore për politikë bërësit, subjektet dhe komunitetin, por ne të gjithë mund të përfitojmë, duke mësuar nga përvojat e të tjerëve edhe nga mjetet që na ndihmojnë të mendojmë dhe veprojmë në mënyrë strategjike. Doracakun e shohim si një dokument të nevojshëm, për një dialog të vazhdueshëm, që do të ndihmojë të mësojmë, të kuptojmë dhe vijojmë të kapërcejmë sfidat e fushës së ruajtjes të natyrës dhe të biodiversitetit.

Duke shfrytëzuar përvojën e IUCN-së dhe të Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), doracaku i advokim-lobimit këshillon mbi praktikat më të mira, për të ndikuar proceset vendimmarrëse, për çështjet e natyrës dhe mjedisit, në nivel kombëtar dhe lokal. Doracaku nuk bën përpjekje për të mbuluar të gjithë procesin e advokim-lobimit në fushën e ruajtjes së natyrës, por paraqet disa udhëzime dhe praktikat më të rëndësishmet për mbrojtjen e natyrës.

Doracaku ofron disa praktika të mira ndërkombëtare, rajonale dhe vendore për hartimin e një strategjie, nëse Ju përpiqeni të ndikoni në politikat, strategjitë e sistemet kombëtare dhe lokale të ruajtjes së natyrës e mjedisit. Kësisoj, në doracak jepen edhe disa nga përvojat dhe aksionet e OShC-ve shqiptare për çështjet e promovimit e të ruajtjes së natyrës, të vlerave dhe përdorimit të burimeve natyrore, me theks mënyrat se si po shfrytëzohen lumenjtë, duke ndërtuar një numër të madh të HEC-ve.

Doracaku është hartuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian (BE), nëpërmjet programit "Mbështetje për kapacitet e Shoqërisë Civile" dhe zba

tohet nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në bashkëpunim me Bashkimin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), në kuadër të projektit *“Fugizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile, për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri”*.



SHKURTIMET

ACHIEVE	Programi “Shoqëria civile shqiptare për një mjedis Evropian”
AdRZM	Administratë Rajonale e Zonave të Mbrojtura
AdZM	Administratë e Zonave të Mbrojtura
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
BE	Bashkimi Evropian
BPK	Bordi i Përbashkët Këshillues
EcoALBANIA	Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri
EDEN	Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim
FoLM	Forumi Lokal Mjedisore
INCA	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri
IUCN	Unioni Ndërkombëtar i Ruajtjes së Natyrës
KDB	Konventa e Diversitetit Biologjik
KE	Komisioni Evropian
KM	Këshilli i Ministrave
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
OMShC	Organizatë Mjedisore e Shoqërisë Civile
ORrMN	Organizatë e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PE	Parlamenti Evropian
PK	Park Kombëtar
PKIE	Planit Kombëtar të Integritimit Evropian
PIM	Plan Menaxhimi
PN	Park Natyror
PNUD	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit
RrKZMM	Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura Mjedisore
RrMN	Rrjeti i Mbrojtjes së Natyrës
RrPZM	Rrjeti Përfaqësues i Zonave të Mbrojtura
SENIOR A-II	Programi “Mbështetje për organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”
URI	Instituti i Kërkimeve Urbane
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësim i Ndikimit Mjedisor
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
WWF	Fondi Botëror për Jetën e Egër
ZM	Zonë e Mbrojtur
ZMM	Zonë e Mbrojtur Mjedisore

Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	4
SHKURTIMET.....	5
1. Përmbledhje rreth doracakut.....	8
Si ta përdorim doracakun e advokacisë dhe lobimit?.....	10
2. Advokacia dhe mjetet për ta përdorur atë.....	13
2.1. Çfarë është advokacia.....	13
2.2. Tipet e advokacisë.....	14
2.3. Hapat e veprimit për advokim.....	15
2.4. Zhvillimi i strategjisë së advokimit.....	17
2.4.1. Përcaktimi i qëllimeve.....	17
2.4.2. Planifikimi i fushatës.....	18
2.4.3. Puna me njerëzit.....	19
2.5. Zhvillimi i mesazhit të strategjisë së advokimit.....	22
2.5.1. Mesazhi kryesor.....	22
2.5.2. Mesazhi i dytësor.....	23
2.6. Komunikimi dhe Media.....	24
3. Lobimi, ndryshimi nga advokacia dhe mjetet për realizimin e tij..	26
3.1. Teknika nën Llojet e Lobimit.....	27
3.2. METODAT TJERA TË LOBIMIT.....	30
4. Ndryshimi midis advokimit dhe lobimit.....	31
5. Komunikimi dhe puna me median.....	32
5.1. Integrimi i medias sociale në punën e advokim-lobimit.....	33
6. PRAKTIKA TË MIRA TË ZBATIMIT TË PROCESIT TË ADVOKACISË DHE LOBIMIT.....	34
6.1 RAST:Krijimi dhe funksionimi i rjetëzimeve në Shqipëri.....	34
6.2 RAST:Identifikimi i problematikave kryesore të mirëqeverisjes së zonave të mbrojtura mjedsore.....	37
6.3 RAST: Promovimi dhe ruajtja e natyrës dhe e burimeve natyrore.....	40
6.4 RAST: Ndërmarrja e veprimeve konkrete dhe të rritjes së përgjegjësisë për mbrojtjen e natyrës, të burimeve dhe të peizazhit natyror..	43
6.5 RAST: Shembuj të zbatimit të proceseve të advokimit në Evropë dhe rajonin e Ballkan.....	60

1. Përmbledhje rreth doracakut

Qëllimi i projektit “Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile, për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri” është të rrisë kapacitetin OShC-ve dhe të partnerëve në mënyrë që qytetarët dhe komuniteti të kenë një zë më të fortë dhe të ndikojnë më mirë në politikat e fushës së ruajtjes të natyrës dhe të burimeve natyrore.

Projekti përmirëson dhe fuqizon aftësitë, potencialin dhe rolin aktiv të OShC-ve e të partnerëve në analizën, monitorimin dhe advokimin e politikave dhe të zbatimit të ligjshmërisë me qëllim përmirësimin e mbrojtjes së natyrës dhe rritjen e ndikimit të OShC-ve, në luftën kundër korrupsionit dhe minimizimin e ndikimeve negative në menaxhimin e burimeve natyrore dhe Zonave të Mbrojtura Mjedisore (ZMM); të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet OShC-ve dhe autoriteteve publike, komuniteteve lokale, mediave dhe të nxisë rrjetëzimin apo ndërtimin e partneriteteve mes tyre.

Qëllimi ynë është të rrisim kapacitetin e organizatave lokale të shoqërisë civile me një sërë mjetesh advokim-lobimit, përcaktimi i ndryshimeve sistematike të arritshme, i hapave të veprimit dhe të elementëve më themelorë, përdorimi i mediave të shkruara e vizive dhe i rrjeteve sociale për të bërë një ndikim të duhur.

Ne, gjithashtu, synojmë të punojmë me OJF-të se si të rrjetëzohen me organizata të tjera apo dhe individë, për të siguruar mbështetjen, si të punojnë brenda kufizimeve shoqërore, sociale dhe financiare të një organizate të re në një rajon lokal.

Pjesë e objektivit tonë është rritja e partneriteteve bashkëpunuese midis OShC-ve dhe qeverisjes (qendrore e lokale) për planifikimin dhe zgjidhjen e problemeve. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, ne synojmë të përmirësojmë pjesëmarrjen dhe reagimet në mes të OShC-ve, publikut dhe qeverisë, në procesin e zhvillimit të ligjeve dhe rregulloreve mjedisore efektive.

Metodologjia përfshin konceptet, rastet dhe praktikat më të mira për advokim-lobim-reagim, metoda të tjera të pjesëmarrjes si dhe zbatimin e presionit publik në procesin e vendimmarrjes, në menaxhimin e ZMM, në hartimin dhe zbatimin e strategjive, politikave, programeve dhe të planeve të përgjithshme vendore, duke pasur në fokus ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe peizazhit natyror.

OShC-të, krahas vijimit të procesit të ngritjes së kapaciteteve të tyre, të promovimit të natyrës, të forcimit të rolit dhe të rritjes së bashkëveprimit konkret me komunitetet, palët e tjera të interesuara, po ndërmarrin iniciativa, duke u përfshirë më mirë në proceset e advokimit, lobimit dhe reagimit ndaj problematikave të ruajtjes së natyrës e të biodiversitetit, në nivel lokal dhe kombëtar; duke rritur presionin dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen e

qëndrueshme të burimeve natyrore, nëpërmjet pjesëmarrjes, sensibilizimit dhe informimit të medias, anëtarëve të këshillave bashkiake, të komisioneve përkatëse lokale, rajonale dhe të Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë drejtim OShC-të kanë një rol të rëndësishëm për t'u angazhuar. Vendosja e bashkëpunimit të ngushtë dhe funksional i OShC-ve është thelbësor për arritjen e qëllimit të tyre. Pa veprime të koordinuara ndërmjet OShC-ve, përpjekjet nuk do të marrin efektin e nevojshëm, prandaj bashkëpunimi i tyre është vendimtar. Ata duhet të rrjetëzohen, të ndajnë informacione apo/dhe të formojnë koalicionë. Veprimi i bashkërenduar dhe ndarja e punës është diçka që do të ndihmojë të mbulojë një gamë të gjerë aktivitetesh, si përgatitja e deklaratave me shkrim, takimi me institucionet përgjegjëse, iniciimi i peticioneve, organizimi i ngjarjeve mediatike, tubime, etj. Është një udhëzues specifik i ndërthurur mes instrumenteve të komunikimit, advokim, lobimit, adresimit e reagimit, nëpërmjet aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese, për një pjesëmarrje më të gjerë dhe aktive të përfaqësuesve të komuniteteve lokale, të forumet e ndryshme vendimmarrëse, për të minimizuar problematikat dhe për të nxitur menaxhimin e përbashkët të burimeve dhe peizazhit natyror.

Doracak Ju ndihmonë me informacione dhe mjete relevante për t'iu mundësuar që të zhvillonit/hartoni dhe zbatoni një Strategji të advokim-lobimi efektive.

Mjetet e parashtuara nxisin të mësuarit e OJF-ve dhe të partnerëve për të rritur përpjekjet e tyre për të advokuar e lobuar në një mjedis të përshtatshëm, për të rritur presionin mbi vendimmarrësit, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e politikave të fushës së ruajtjes të natyrës, nga OShC-të dhe nga ekspertët, të cilët kanë qenë të suksesshëm në advokim-lobim.



PK Divjakë-Karavasta

Si ta përdorim doracakun e advokacisë dhe lobimit?

Advokim-lobimi është proces strategjik dhe i qëllimshëm për të sjellë ndryshime në politikat dhe praktikat mjedisore e natyrore. Kjo mund të ndodhë në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Një strategji advokuese-lobimi, që kërkon të arrijë ndryshime gjithëpërfshirëse, duhet të përfshijë aktivitet të koordinuara në të gjitha nivelet.

Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për advokim-lobim është më tepër politik sa një çështje e zhvillimit të aftësive teknike. Kjo kërkon aftësi për advokim strategjik për të ndikuar tek vendimmarrësit, për të rritur kërkesën për vlerësim dhe shqyrtim të politikave të ruajtjes së natyrës. Advokim-lobimi të synojë drejtpërdrejtë dhe tërthorazi vendimmarrësit dhe palët e tjera të interesit, për të mbështetur dhe zbatuar veprime që kontribuojnë në përmbushjen e një kuadri politikë gjithëpërfshirës.

Advokim-lobimi nuk duhet të synojë thjesht të ndryshojë politikat dhe praktikat, por të sfidojë dhe të ndryshojë mënyrën se si njerëzit perceptojnë aftësinë e tyre për t'u integruar në proceset vendimmarrëse.

Në këtë kontekst disa OShC po i adresojnë çështjet e ruajtjes së natyrës dhe të burimeve natyrore përmes projekteve dhe programeve, të cilat janë bërë pjesë e punës së tyre, duke përfshirë advokimin në të gjitha planet e tyre strategjike. Në thelb përdorimi strategjik i advokimit është për të ndikuar në politikat e fushës së ruajtjes të natyrës dhe një përpjekje për të përmirësuar cilësinë e jetës së komuniteteve.

Shpesh politikat lokale e kombëtare, për të mbrojtur natyrën dhe burimet e saja, mungojnë, janë joefektive ose nuk zbatohen. Në këtë kuadër advokim-lobimi është procesi i qëllimshëm i ndikimit të atyre, të cilët marrin vendime për zhvillimin, ndryshimin dhe zbatimin e politikave.

- Advokim-lobimi i OShC-ve, në rastin tonë, fokusohet në çështjen e mirëqeverisjes së ZMM-ve dhe të përdorimit të balancuar të burimeve natyrore.
- Pjesë e rolit të OShC-ve është të lehtësojë ose të krijojë ura mes njerëzve që jetojnë, brenda dhe në afërsi të ZMM-ve dhe institucioneve lokale, qeverisë qendrore, parlamentit, etj, roli i të qenit një mbledhës është, në fakt, një qendër për promovimin e dialogut që rezulton në përmirësimin e politikave dhe të legjislatcionit pro natyrës.
- Për OShC-të, advokim-lobimi është mjeti më të cilin duhet të ndikojnë vendimmarrësit ose taktikat, ndërsa politika është përmbajtja, atë që duam të ndryshojmë.

Përdorimi i doracakut do të ndihmojë si të përcaktoni mjete të veçanta që iu interesojnë më së shumti, në varësi të nevojave individuale dhe në cilën fazë jeni aktualisht për planifikimin e strategjisë të advokim-lobimit. Gjatë këtij procesi, njëherazi, mund të dëshironi të shqyrtoni se si mund të interpretohen hapat në lidhje me rrethanat specifike, në varësi të faktit nëse fokusoheni në nivel kombëtar apo lokal, për të cilin janë bërë rekomandime apo këshillat për strategjinë në këtë doracak. Ky doracak ofron një sërë hapash shtesë që mund të ndërmerren për të mbrojtur në mënyrë efektive politikat dhe sistemet kombëtare e lokale të vlerësimit të fushës së natyrës, të cilat orientohen drejt standarteve evropiane dhe ndërkombëtare.

Gjatë gjithë procesit të përdorimit të doracakut Ju do të njiheni me:

KËSHILLA KRYESORE: Përcaktimi i ideve dhe të kuptohet se si mund t'iu ndihmojnë të ndërtoni një strategji efektive advokim-lobimi.

MJETET: Ushtrime për planifikimin, aktivitetet e seminareve dhe modelet që do t'iu ndihmojnë të punoni për ndërtimin e strategjisë, mjetet praktike që duhen përdorur.

RASTE STUDIMI: Shembuj të dobishëm se si të tjerët kanë zhvilluar dhe zbatuar strategjitë e advokim-lobimit, praktikat më të mira dobiprurëse dhe veprimtaritë e kryera në këtë drejtim.

Mekanizmi parësor për OShC-të dhe palët e tjera të interesit, për t'iu angazhuar me advokim-lobim, është nëpërmjet grupimeve, rrjetëzimeve, koalicionëve dhe partneriteteve.

OShC-të duhet të angazhohen që të punojnë në konsultime të hapura dhe të gjera me institucionet relevante kombëtare e lokale të fushës së ruajtjes së natyrës dhe palët e tjera të interesuara (të prekura dhe kundërshtarë).



RNM "Kune-Vain-Toie"

2. Advokacia dhe mjetet për ta përdorur atë

Paramendoni se po punoni si iniciativë e OJQ-ve ose qytetarëve në një vend demokratik dhe jeni të përqendruar në tema specifike, që kanë të bëjnë me probleme të rëndësishme në shoqëri. Nëse gjithçka funksionon mirë, ju do të lini zgjidhjen e shumë problemeve në vetëqeverisjen lokale ose në atë shtetërore (ministritë ose zyrat e administratës shtetërore). Por, edhe në demokracinë më të mirë, asgjë nuk funksionon mirë gjatë gjithë kohës, shteti mund të dështojë çdo ditë në sigurimin e përgjegjësive themelore dhe nganjëherë është shteti, ose të paktën përfaqësues të pushtetit, të cilët krijojnë probleme. Të drejtat e fëmijëve, të rinjve ose të personave me nevoja të posaçme neglizhohen ose shkelen, lumenjtë janë të ndotur dhe monumentet shkatërrohen, korrupsioni dhe mungesa e transparencës lulëzon çka çon në harxhimin e burimeve publike. Kështu gjithçka ndodh në një botë të trazuar, ku ne po përballemi gjithnjë e më shumë jo vetëm me sfidat lokale dhe rajonale, por edhe globale: varfëria dhe pabarazitë ekonomike, konfliktet e luftës, ndryshimet klimatike, migracioni, përplasjet e vlerave dhe radikalizimi i shoqërisë ose mungesa e demokracisë. Demokracia funksionon mirë kur sektori jofitimprurës dhe shoqëria civile punojnë mirë; kur qytetarët dhe OSHC-të janë aktive dhe mbrojnë të drejtat e tyre ose të drejtat e grupeve të caktuara. Në këtë pjesë të doracakut do të flasim rreth asaj se si të sjellim një ndryshim përmes advokimit të qytetarëve, nëpërmjet qasjes që fokusohet në arritjen e ndryshimeve në shoqëri në përputhje me vlerat demokratike.

2.1. Çfarë është advokacia

Advokimi është një strategji për të ndikuar në politikëbërësit (p.sh. njerëzit me pushtet formal politik si anëtarë të parlamentit, zyrtarë qeveritarë, politikanë apo nëpunës publikë) për të bërë një ndryshim të politikave publike - përgatitjen dhe miratimin e ligjit, strategjisë, planit ose rendit të ditës; program ose kurs veprimi; shpërndarjen e burimeve apo ndryshimin institucional. Përpjekjet e advokatisë mund të realizohen përmes një sërë hapash të caktuar, duke përdorur strategji ose qasje të ndryshme.

Ky përkufizim shpreh një ide të rëndësishme, pasi advokimi nuk ka të bëjë vetëm me ndikimin e politikës, por, gjithashtu, dhe para së gjithash, me ndikimin tek opinionit publik. Pra, advokimi është një proces i ndryshimit social që ndikon në qëndrimet, marrëdhëniet shoqërore dhe të pushtetit, i cili forcon shoqërinë civile dhe hap hapësirat demokratike. Për të përmbushur aspiratat e tij, advokimi kërkon koordinim të përpjekjeve, mendim strategjik, informacion, komunikim dhe mobilizim. Advokimi është një proces ose një veprim për të siguruar respektimin dhe efektivitetin e të drejtave të komuniteteve apo dhe individëve.

Çdokush mund të fillojë një veprim advokatie, por sa më shumë të jetë i strukturuar dhe i organizuar, aq më i lartë është shansi i suksesit. Advokimi:

- është një strategji për të ndikuar në ndryshimin e politikave ose veprimeve;
- realizohet me audiencën primare të vendimmarrësve;
- përmban një proces të qëllimshëm të komunikimit bindës, që kërkon ndërtimin e mbështetjes prapa politikës së propozuar;
- kryhet nga grupe të qytetarëve të organizuar.

Advokimi, në të gjitha format e tij, kërkon të sigurojë që komuniteti, veçanërisht ata që janë më të prekshëm, të jenë në gjendje që:

- Të shprehin pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre.
- T'u dëgjohet zëri për çështje që janë të rëndësishme për ta.
- T'u mbrohet dhe të mbrojnë të drejtat e tyre.
- Të kenë qasjen e informacioneve dhe shërbimeve.
- T'u merren parasysh pikëpamjet dhe dëshirat e tyre në vendimmarrjet që lidhen me jetesën e tyre.
- Të mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.
- Të zbulojnë zgjedhjet dhe opsionet më të përshtatshme për arritjen e qëllimeve.

Në rastin e projektit “Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile, për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri”, advokimi synon, drejtpërdrejtë dhe tërthorazi, të përfshijë vendimmarrësit dhe palët e tjera të interesit për të mbështetur e zbatuar veprime që kontribuojnë në përmbushjen e një kuadri politikë gjithëpërfshirës si dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të fushës së ruajtjes të natyrës.

2.2. Tipet e advokacisë

Për të qenë në gjendje të përqendrohemi në drejtimin e duhur, është mirë të dimë të dallojmë midis disa llojeve të advokimit.

Advokimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë

Dallimi ndërmjet advokimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë bazohet në atë se kush është synimi i përpjekjes sonë të advokimit. Advokimi i drejtpërdrejtë nënkupton që individët ose organizatat po përpiqen të ndikojnë në vendimmarrësit, politikëbërësit dhe udhëheqësit politikë për të ndryshuar politikën publike. Në advokim indirekt, individët ose organizatat po përpiqen të ndikojnë në opinionin e publikut të gjerë, gazetarëve dhe medive, të cilët do të ndikojnë tek vendimmarrësit.

Koha për të përdorur advokimin e tërthortë është nëse politikanët nuk janë të ndjeshëm ndaj përpjekjeve tona, por ato perceptohen si kërcënim nëse

humbasin mbështetjen e publikut. Nëse përqendrohemi në ndikimin e publikut, si përmes mediave, presioni publik mund t'i detyrojë politikanët të ndryshojnë mendjet e tyre.

Advokimi i qytetarëve dhe vetë-advokimi

Pika fokale në këtë dallim është agjenti (avokati) i përpjekjeve të advokimit. Në rastin e advokimit të qytetarëve, një çështje është paraqitur në emër të një grupi njerëzish. Në rastin e vetë-advokimit, një individ ose një grup po përpiqet për çështjen e vet. Vetë-advokimi, mund ta ndeshim kur një grup njerëzish që kanë të lidhur jetën e tyre me burimet natyrore advokon për të drejtat e tyre. Advokimi qytetar përdoret shpesh në zhvillimin urban, kur njerëzit nuk luftojnë për ndryshimin e politikave, gjë që është e mirë vetëm për ta, por që ka të bëjë me të gjithë qytetarët.

Advokimi i bazuar në të drejtat dhe advokimi i bazuar në fakte

Në rastin e advokimit të bazuar në të drejta, qëllimi është të ndikojë politikëbërësit nëpërmjet argumentimit të bazuar në të drejtat e përgjithshme të deklaruara të njeriut, të cilat janë të kodifikuara në deklarata ose në forma të ndryshme të legjislacionit. Advokimi i bazuar në dëshmi sjell argumentimin bazuar në dëshmi ose në të dhëna të hulumtimit. Nëse situata lejon përdorimin e argumenteve substanciale, nëse kemi të dhëna të forta dhe ne mund t'i prezantojmë dhe t'i interpretojmë ato për të mbështetur rastin tonë, atëherë është e drejtë dhe e dëshirueshme të përdorim advokimin e bazuar në prova.

Advokimi bashkëpunues ose i konfrontimit

Ka edhe më shumë mënyra se si të dallohen llojet e ndryshme të advokimit, në varësi të perspektivës që ne zgjedhim. Kur të fokusohemi në atë se a duhet të bashkëpunojmë apo të luftojmë në vendosjen e qëllimeve të advokimit, atëherë mund të flasim për advokim bashkëpunues ose konfrontim. Të dy qasjet në advokim përdorin mjete të ndryshme - advokimi konfrontues përdor peticione, padi, demonstrata, etj., advokimi bashkëpunues përdor më shumë negociata ose mjete për rritjen e ndërgjegjësimit.

2.3. Hapat e veprimit për advokim

Natyrë në Shqipëri është shumë e fragmentuar dhe e paafte për të reaguar në mënyrë efektive ndaj presioneve të reja dhe kërcënimeve të vazhdueshme, duke përfshirë prerjet ilegale, peshkimin, gjuetinë, turizmin e pakontrolluar dhe aktivitetet rekreative, ndotjen, mostrajtimin e ujërave të zeza e të përdorura, erozionin bregdetar, zjarret, ndikimet e ndryshimeve klimatike, zbatimin e dobët të ligjit dhe qasjet e paefektshme të menaxhimit në praktikë. Natyra shqiptare po vuan këto dukuri, në shumë raste të pakthyeshme, që kanë ndikuar seriozisht në habitatet e specieve të rrezikuara dhe të rrezikuara në mënyrë kritike.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore ende nuk është integruar, siç duhet, në politikat kombëtare dhe lokale. Përfshirja e komuniteteve lokale në menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe të burimeve lokale të natyrës është e pamjaftueshme. Kjo situatë pengon zbatimin efektiv të politikës së mjedisit dhe ruajtjes së natyrës dhe lehtësisht çon në konflikte dhe keqkuptime të panevojshme, pasi një pjesë e madhe e popullsisë jeton në rajone rurale e të largëta.

Në thelb, advokimi është **“ushtrimi i presionit nga ana e qytetarëve përballë pushtetit të qeverisjes”**. Advokimi është një mjet për pjesëmarrjen reale të qytetarëve në vendimmarrjet nga qeveria dhe organe të tjera të fuqishme. Në të njëjtën kohë, advokimi duhet të shkojë përtej angazhimit të “qytetarëve” për të angazhuar qytetarët dhe jo-qytetarët. Në këtë rast advokimi duhet të konsiderohet si: **Akti i dhënies së mbështetjes për një politikë dhe bindjen e atyre që kanë fuqi për të vepruar në mbështetje të politikës, në nivel lokal dhe kombëtar.**

Kur flasim për advokimin, pyetja më e shpeshtë nga OSHC-të ka të bëjë me përgatitjen dhe zbatimin e një procesi ose veprimi të suksesshëm advokimi. Është e dobishme të dimë, çfarë hapash do të ndërmerrem dhe çfarë duhet bërë për të arritur një ndryshim.

Është mirë të kuptohet se advokimi i qytetarëve zakonisht është një proces afatgjatë i cili ka logjikën e vet, përbëhet nga komponentë kryesorë dhe ndjek disa hapa ose faza. Këto faza mund të ndryshojnë në kohë dhe hapësirë, por është mirë të mbani mend se cilat janë gjërat kyçe për të identifikuar dhe punuar me të, kur jeni duke shkuar për të arritur një ndryshim. Për të zhvilluar strategjinë tuaj të advokatisë ose për të përgatitur një fushatë, ju duhet t’u përgjigjeni pyetjeve duke përfshirë:

Çështja	<i>Cilat çështje doni të ndryshoni politikën publike? Cila është situata aktuale në këtë fushë?</i>
Qëllimi dhe objektivat	<i>Çfarë doni të arrini? Cili është qëllimi juaj i advokimit, cilat janë objektivat që do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit tuaj të përgjithshëm?</i>
Grupet e synuara	<i>Cilët janë objektivat (krijuesit e politikave, vendimmarrësit, etj.) Që ju duhet të adresoni për të arritur qëllimin tuaj?</i>
Tipet e advokatisë	<i>Cila është qasja juaj ndaj advokimit (p.sh., drejtpërdrejt ose indirekt)?</i>
Aktivitetet	<i>Cilat janë aktivitetet specifike që do të kryeni? Cila do të jetë afati dhe shkalla e ndikimit?</i>
Mesazhi	<i>Cili është mesazhi juaj i advokimit që dëshironi t’i dërgoni grupit tuaj të synuar?</i>

Në fillim ju duhet të merrni vendimin se çfarë çështje (brenda fushëveprimit tuaj të punës) do të merreni me të dhe çfarë doni të arrini. Është koha kur po shikoni përreth, duke bërë kërkime për aspekte të ndryshme të situatës. Ju duhet të pyesni se çfarë pikërisht ju e konsideroni si problem dhe kujt është problemi i rëndësishëm. Ju gjithashtu duhet të gjeni se çfarë është gjendja aktuale, dhe cilat janë politikat, ligjet dhe rregulloret përkatëse që e formësojnë gjendjen aktuale.

Shembull për zgjedhjen e çështjes për advokim

Ndër synimet/veprimet kryesore të OShC-ve përfshihet advokimi legjislativ, që mund të shoqërohet me një reformë të gjerë të sistemeve ligjore të fushës së ruajtjes të natyrës, e cila jo vetëm që kërkon të krijojë ose ndryshojë legjislacionin, por edhe të sigurojë që një legjislacion i tillë të zbatohet siç duhet.

Advokimi për reformën e sistemit ligjor është aktiviteti specifik i OShC-ve për krijimin dhe adoptimin e politikave dhe procedurave që zbatojnë ose japin efekt mbi legjislacionin ose ndryshimet në legjislacionin ekzistues. Advokimi në këtë rast duhet të përfshijë përmirësimin e reagimit ndaj zbatimit të ligjit, të identifikojë boshllëqet e zbatimit dhe kërkon për të bashkëpunuar me anëtarët e sistemit ligjor për të krijuar procese, procedura dhe programe të reja.

2.4. Zhvillimi i strategjisë së advokimit

Kjo pjesë e advokimit përqendrohet në përgatitjen e qartë të qëllimeve dhe objektivave, identifikimin e audiencës së synuar dhe zgjedhjen e qasjes adekuate të advokimit.

2.4.1. Përcaktimi i qëllimeve

Përcaktimi i asaj që duam të arrijmë është vendimtar. Kur kemi një qëllim të përcaktuar mirë, ne mund të mbështetemi plotësisht në të dhe na ndihmon të udhëheqim përmes pengesave dhe të përcaktojmë edhe gjëra të tjera: kujt dëshirojmë të adresojmë, cilat strategji dhe mjete duhet të përdorim. Qëllimi në përpjekjet ose fushatën tonë duhet të përcaktojë një ndryshim specifik në një politikë që do të dëshironim të arrijmë. Është e domosdoshme të shkruash një qëllim të një folje aktive që përcakton dhe veprimin dhe specifikimin e zonës me të cilën përqendrohemi.

Përgatitja e qëllimeve të advokimit / Ushtrimi

Nëse jeni tashmë aktive në fushën e avokatisë ose po planifikoni aktivitetin e advokimit, përpiquni të përgatitni të paktën 3 qëllime të ndryshme për çështjen tuaj. Mundeni, por nuk duhet të përdorni fillimet e mëposhtme të fjalive:

Të informojë rreth ...

Të rritë interesin në ...

Të tregojë problemin, që...

Të mobilizojë (të ndërmarrë veprime) ...

Të ndryshojë politikën, e cila ...

Të nxitë zbatimin ...

2.4.2. Planifikimi i fushatës

Kur të keni një strategji, duhet ta përktheni atë në planin e advokimit që nuk është gjë tjetër veç një grup aktivitete të qarta dhe të strukturuar brenda një afati kohor të caktuar. Është e nevojshme të vendosni, se si do ta transformoni strategjinë tuaj në aktivitete, sa logjikisht do të jenë fazat e fushatës suaj ose aktivitetet tuaja të lidhura dhe mbështetur me njëra-tjetrën dhe cila do të jetë koha dhe niveli i fushatës. Plani duhet të përmbajë edhe linjën e medias me mesazhin kryesor që dëshironi të merrni dhe vendimet mbi strategjitë e advokimit që do të përdorni - presionin e publikut dhe mediave, negociatat, lobimin, etj. Për të qenë në gjendje të realizoni veprimet duhet të kërkonti burime (*financiare, materiale, lehtësira, etj.*) dhe zhvilloni një buxhet, por është mirë të dihet se nëse nuk keni burime, ju mund të përdorni fonde nëpërmjet njerëzve që kanë interes për çështjen.

Përgatitja e fushatës / Ushtrimi

Paramendoni se po përgatitni një fushatë të fokusuar në arritjen e qëllimeve që keni përcaktuar. Cilat hapa do të sugjeronit të ndërmerrni, brenda së cilës kohe specifike?

Përpiquni të identifikoni aktivitetet kryesore në rendin logjik:

Koha e aktivitetit	Aktiviteti

2.4.3. Puna me njerëzit

Kur flasim për njerëzit në advokim mund të shikojmë nga këndvështrime të ndryshme mbi "kush është kush". Bashkëpunëtorët janë njerëz që ndikojnë në problemin dhe zgjidhjen e tij, ose janë të ndikuar nga problemi. Thjesht duke folur, gjithkush është "të cilit i përket".

Në fillim të punës suaj është e rëndësishme të hartojmë dhe analizojmë palët e interesuara dhe të shohim se cilët janë njerëzit e interesuar për kauzën tuaj, sa kundërshtarë apo përkrahës të mundshëm kenë. Analizimi i palëve të interesuara dhe kuptimi i motivimit dhe interesave të tyre iu jep bazën për përgatitjen e hapave të veçanta të veprimit. Nëse nuk e krijoni me kujdes hartën e partnerëve, nuk do të jeni në gjendje të punoni plotësisht me potencialin njerëzor përreth jush.

Mjet i rëndësishëm në përgatitjen e veprimtarisë së advokimit është matrica e analizës së palëve të interesit (Bryson, 1995) e cila kombinon dimensionin e interesit (deri në ç'masë njerëzit janë të interesuar për çështjen tuaj) dhe ndikimin / fuqinë (deri në ç'masë njerëzit janë në gjendje të ndikojnë në punën tuaj, fuqia që ata kanë). Kombinimi i këtyre dy dimensioneve identifikon 4 grupe të ndryshme me 4 strategji të ndryshme për t'u marrë me to dhe ndihmon procesin e advokimit që të jetë më efektiv në përpjekjet për të adresuar këta njerëz.

Kombinimi i dimensionit	Veprimet e rekomanduara për tu ndërmarrë
Interes i ulët / fuqi e lartë	Mbani aktorët të kënaqur duke plotësuar nevojat e tyre. <i>Nëse ata nuk janë të interesuar për çështjen tuaj, përpuni të punoni me ta dhe t'i vendosni në fushën e kuqe duke gjetur atë që ata janë të ndjeshëm ose cilat janë motivet e tyre.</i>
Interes i lartë / fuqi e lartë	Grupi më i rëndësishëm për të punuar me ju, duhet ta menaxhoni këtë grup nga afër. Nëse ata mbështesin rastin tuaj, është e nevojshme bashkëpunimi i ngushtë për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e tyre; nëse ata janë kundërshtarët tuaj, ju duhet të planifikoni gjithçka me shumë kujdes për të minimizuar dëmet.
Nuk ka interes / nuk ka fuqi	Mbajeni këtë grup të informuar dhe monitoroni sjelljen e tij. <i>Megjithëse nuk kanë fuqi për të ndikuar ende në gjëra, përzjerja e mirë e informacionit mund t'i ndihmojë ata të jenë të dërguarit tuaj për grupe të tjera dhe të lëvizin në kutinë e djathtë.</i>

Interes i lartë / nuk ka fuqi

Përdorini këta njerëz duke përdorur interesin dhe bashkëpunimin e tyre në zonat me rrezik të ulët; i informoni dhe këshillohuni me ta. Njerëzit, të cilët aktualisht nuk kanë fuqi për të ndryshuar gjërat, mund t'ju ndihmojnë p.sh. si vullnetarët më të mirë në fusha të ndryshme.

Një tjetër term i përdorur në advokim është **objektivi**. Përdoret për të emëruar një person të rëndësishëm që ka fuqinë për të ndryshuar gjërat - zakonisht politikanët apo vendimmarrësit, përfaqësues të institucionit. Përdorimi i këtij termi është i lidhur me strategjitë e lëvizjes së ndryshimeve shoqërore ose fushatat e përshkuara në librin "Si të fitoni fushata" (Rose, 2010), por edhe diku tjetër. **Objektivi kryesor** është gjithmonë një person, jo një institucion; dikush që mund të ndryshojë politikën, legjislacionin ose buxhetin (**vendimmarrësit** - nga kryetari i bashkisë tek ministri), objektivi i mesëm është dikush, i cili mund të ndikojë në këtë person (**influencues**).



Koalicionet dhe rrjetet janë grupe të mëdha njerëzish me strukturë të lirshme ose të ngushtë që ndihmojnë në advokimin për çështje të veçanta duke përhapur informacionin, duke ndihmuar në zbatimin e aktiviteteve tuaja ose duke mbështetur dhe bashkëpunuar për shkak të qëllimeve të ngjashme. Rrjeti përbëhet nga individë ose organizata që ndajnë informacione, ide, burime ose qëllime për të përmbushur qëllimet individuale ose grupore (Jackson dhe Maddy, 1991); rrjetëzimi është një proces i marrjes së burimeve dhe fuqisë së ndërtimit duke krijuar dhe përdorur lidhjet midis dy ose më shumë individëve,

grupeve ose organizatave. Koalicioni është një grup individësh, përfaqësuesish ose organizatash që punojnë së bashku për një kauzë të përbashkët, për të përmbushur një qëllim të përbashkët ose për të zgjidhur një problem të përbashkët.

Është e rëndësishme të dini cilët janë aleatët tuaj të mundshëm dhe kush mund të krijojë koalicione ose rrjete, sepse në punën e advokimit, sidomos në advokimin e tërthortë, mund të ndikoni në suksesin tuaj duke përdorur fuqinë dhe kapacitetin e organizatave të tjera. Nëse ju mungojnë disa aftësi, kontakte, burime; nëse doni të arrini audiencë më të gjerë, atëherë është e nevojshme të punoni me organizata me interesa ose vlera të ngjashme. Koalicionet dhe rrjetet ndihmojnë në përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore (shkathtësi, njohuri, motivim, ekspertizë), rrisin ndikimin e fushatës, ndihmojnë në krijimin e strukturës organizative dhe sigurojnë mbështetje reciproke.

2.4.4. Trajtimi i aleatëve

Puna për trajtimin dhe vlerësimin e aleatëve, duhet të përqendrohet:

- Të bindësh aleatin që pozicioni dhe puna e organizatës suaj është e drejtë dhe e nevojshme për çështjen që advokoni.
- Bindni aleatin se çështja, programi, objektivat dhe masat/veprimet e paracaktuar janë të rëndësishme, ato që duhen dhe të mjaftueshme për të garantuar suksesin.
- Bindni aleatin për nevojën dhe garancinë që sjell krijimi i aleancave për një advokim efektiv.
- Bashkëpunimi ndikon për të rritur kapacitetet e ndërsjella dhe për të rritur ndikimin mbi vendimmarrësit.

Gjërat kryesore që duhet të dini rreth aleatëve:

- Sa mirë e mbështetin çështjen e advokim-lobimit?
- Çfarë mendojnë me të vërtetë për zgjidhjet e çështjeve?
- A kanë ndonjë dyshim për fushatën e advokim-lobimit?
Nëse PO, cilat janë ato?
- Çfarë shpresojnë të fitojnë nga procesi i advokim-lobimit?
- Cila është baza dhe mbështetja e tyre për fushatën?
- Çfarë mund të bëjnë ata për të mbështetur fushatën?
- Sa të përfshirë dhe të informuar presin ata, të jenë?
- A kanë çështje me ndonjë aleat tjetër të ardhshëm?

2.4.5. Trajtimi i kundërshtarëve

Analiza dhe trajtimi i kundërshtarëve është më thelbësorja, pasi lidhet ngushtësisht me interesa të mëdha, por dhe me procesin e fushatës së advokim-lobimit. Mund të konsiderojmë si "kundërshtarë" të një veprimi advokim-

lobimi, njerëzit, organizatat, institucionet dhe subjektet të cilët mund të kenë një ndikim negativ në arritjen e qëllimit. Ata nuk duhet të konsiderohen thjeshtë si përfaqësues të pikëpamjeve ndryshe, por duhen vlerësuar maksimalisht për potencialin që disponojnë dhe argumentimet e tyre që janë kundër qëndrimit tuaj.

Në të dyja rastet, duhet të jeni gatë për të ndarë skenën me kundërshtarët, duhet të njihni objektivat e tyre dhe të jeni në gjendje të jepni argumente për të kundërshtuar pozicionet e tyre. Në rast se kenë të dhëna të sakta, fakte dhe shifra Ju jeni në gjendje të kryeni mirë një debat publik ose të hidhni poshtë pretendimet/komentet e tyre. Kjo mund të bëjë dallimin midis një veprimi të fuqishëm dhe efektiv të advokimit-lobimit me një iniciativë të dobët.

Qëndroni të qetë, me respekt dhe njihni kush është kundërshtari juaj. Kjo u ndihmon të mbani hapur audiencën për të dëgjuar argumentet tuaja. Menjëherë hidhni poshtë pasaktësitë si në media dhe kur jeni ballë për ballë. Mos harroni se subjektet e industrisë dhe të këtij sektori kanë shumë më tepër burime dhe ata përpiqen t'iu kundërvihen fuqishëm.

Prania e medias, qoftë pozitive apo negative, është thelbësore për të adresuar kundërshtarët dhe hedhjes poshtë të argumenteve të tyre.

2.5. Zhvillimi i mesazhit të strategjisë së advokimit

Një mesazh gjithëpërfshirës duhet përshkruar në strategjinë e advokimit-lobimit. Nëse mesazhet janë të shumta, të paqarta ose shumë komplekse ata nuk mund të tërheqin vëmendjen e audiencës së synuar ose do të kenë ndikim të papërfillshëm.

Nëse qëllimi është i qartë, objektivat specifike janë përcaktuar drejtë dhe Ju e dini se çfarë ndryshimi kërkoni të bëni, thelbësore është të identifikoni se kush mund ta bëjë ndryshimin. Po kështu, është e dobishme të kujtoni rëndësinë e të pasurit të një pasqyre të qartë të kontekstit politik, legjislativ dhe të problematikave që doni të ndikoni, veçanërisht në lidhje me njerëzit ose institucionet që kanë fuqinë për të filluar ndryshimin. Ky mund të jetë një mjet i dobishëm për të siguruar palët e interesuara që luajnë një rol efektiv në përpjekjet për ndryshim dhe për procesin e vendimmarrjes. Njohja e përditësuar e situatës, njerëzve dhe e proceseve, është e nevojshme në mënyrë që të jeni të përgatitur për të advokuar e lobuar.

2.5.1. Mesazhi kryesor

Mbani në mend se mesazhi do të duhet të përhapet në një "rrjet të brendshëm" të përbërë nga DShC-të mjedisore, të cilat ndajnë të njëjtin qëllim, si dhe të një "rrjeti të jashtëm" të palëve të interesuara, që mund të jenë përkrahës apo kundërshtarë.

Mesazhi kryesor duhet të kontrollohet nga staff i OShC-së për të siguruar që të jetë në përputhje me mesazhin e përgjithshëm, i verifikueshëm me realitetin, të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për audiencën. Pra, për të bërë dallimin e një mesazhi të mirë është rezultati, cila është dobja apo vlera e shtuar për audiencën, çfarë po mbrojmë, se çfarë ata apo/dhe të tjerët mund të fitojnë nga të bërit e advokim-lobimit. Mesazhi i adresuar në këtë sens, ka më shumë gjasa të pranohet prej tyre.

Zakonisht mesazhi më universal për audiencën e synuar, duhet të përfshijë:

- Deklarata: ideja juaj qendrore ose analiza/shkaku i problemit. Përkrahuesit ose ndryshimi është i rëndësishëm.
- Dëshmia: mbështetësit deklarohen me fakte (të kuptueshme), duke përdorur gjuhën e përshtatur.
- Qëllimi: theksoni atë që dëshironi të arrini/realizoni.
- Veprimi i dëshiruar: zgjidhja (ose zgjidhja e pjesshme) e problemit, përbën thelbin e një mesazhi advokim-lobimi dhe e dallon atë nga shumë lloje të tjera të komunikimit.

2.5.2. Mesazhi i dytësor

Shpjegon se si do të përmbushen objektivat e mesazhit kryesor. Por, mesazhet dytësore duhet të jenë të përshtatura për audiencën më të gjera, më të veçanta, p.sh. me vendimmarrësit, mediat, subjektet, publikun i gjerë, etj. Mesazhi duhet të tregojë rëndësinë e çështjes dhe shqetësimet e komunitetit dhe të administratorëve të burimeve natyrore; se çfarë duhet të ndryshojë dhe çfarë duhet të merret në konsideratë. Zhvillimi i këtij mesazhi, që adreson dhe përforcon aspekte specifike të mesazhit kryesor, në rastin tonë, mirëqeverisja e ZMM-ve dhe të burimeve natyrore, bënë të mundur që komuniteti dhe shoqëria të ndihmojnë në përcjelljen efektive të mesazhit, të ndërtohen marrëdhënie dhe besim të ndërsjellë me strukturat vendimmarrëse.

Çdo mesazh kërkon dëshmi sasiore, dhe nëse të dhënat, faktet, shifrat ose provat, janë cilësore dhe të vërtetuara. Kur mesazhi është i qartë, rrjetet dhe koalicionet mund të ndihmojnë në kthimin e këtij mesazhi në një valë të fuqishme ndryshimi.

Bazuar në përvojat ndërkombëtare e rajonale, ekzistojnë një numër medimesh të ndryshme që mund t'i përdorni për të shpërndarë mesazhet e fushatës së advokim-lobimit. Rastet studimore, në drejtim të problematikave të qeverisjes së ZMM-ve dhe të burimeve natyrore, ndajnë disa shembuj të mirë dhe të suksesshëm, të cilat mund të ndihmojnë në informimin e komunitetit, përdoruesve të burimeve natyrore, të politikë bërësve dhe vendimmarrësve, si dhe të medias, pra, mund të jenë më të përshtatshme për strategjinë e advokim-lobimit.

2.6. Komunikimi dhe Media

Komunikimi me mediat është një mënyrë se si të rritet rëndësia e kauzës duke e sjellë atë në publik përmes mediave dhe duke ndërtuar një komunitet mbështetësish.

Komunikimi konsiderohet aktiviteti i advokues nëse grupet e synuara e përdorin atë për të ushtruar presion mbi procesin e hartimit të politikave. Nga një këndvështrim i caktuar mund të konsiderohet si një strategji specifike e komunikimit, por për shkak se çdo strategji e lartpërmendur mund të ketë linjë të veçantë mediatike për të rritur ndikimin e saj, ne e paraqesim atë veç e veç.

Qëllimet e ndryshme të komunikimit ndryshojnë në aspektin e ndikimit dhe vështirësive të tyre. Nëse dëshironi të informoni, të përshkruani diçka, t'i bëni gjërat të dukshme dhe të kuptueshme, është mirë të përdorni fakte me infografikë. Kurrë mos harroni informimin - duke përdorur broshura, filma, karikatura, infografikë, etj. Kur krijohet një mesazh, mos harroni të komunikoni shkurt dhe thjesht, të jeni personal, tregoni historinë dhe reagoni në nevojat reale dhe gjendjen e njerëzve duke përdorur gjuhën e tyre dhe argumentet ku ata janë të ndjeshëm ndaj çështjes që doni të informoni.

Kur doni të rritni interesin, ndryshoni perceptimin e një teme ose problemi, duhet të përdorni mesazh më të fortë, të mbështetur p.sh. nga personalitete të famshme dhe mesazhet e tyre - shembuj dhe histori personale janë të mira për të frymëzuar dhe motivuar njerëzit.

Më e vështirë është të takohen qëllimet e orientuara në ndalimin e dikujt nga diçka ose mobilizimi i dikujt për të bërë diçka, sepse për t'i bindur njerëzit ka nevojë për shumë energji.

Me përjashtim të qasjeve të përmendura në linjat e hershme, është mirë të krijohen ekspertizë dhe ndikim duke ftuar ekspertët dhe vendimmarrësit në tryeza të rumbullakëta, në diskutimet e paneleve, në organizimin e konferencave; bërja e dokumenteve të politikave, botimi i hulumtimeve - kjo gjithçka krijon një përmbajtje të re, zhvillon argumente dhe sjell vëmendjen e publikut dhe medias në kauzën tënde.

Sidomos në advokim është e rëndësishme të përdorësh vizualizim dhe infografikë që ndihmon në përkthimin e argumenteve dhe fakteve në imazhe të forta. Kur ne përdorim qasje p.sh. e advokimit indirekt bazuar në prova, objektivi ynë është publiku dhe opinioni i tyre.

Përmes fushatave mediatike ne mund të ofrojmë dëshmi për publikun dhe të japim argumente, pse ndryshimi i politikave është i nevojshëm. Kur avokatët arrijnë të bindin opinionin publik për shkakun e tyre, politikëbërësit mund të ndikohen nga ndryshimi i politikave.



3. Lobimi, ndryshimi nga advokacia dhe mjetet për realizimin e tij

Termi “Lobim” përshkruan përpjekjet e drejtpërdrejta për të ndikuar tek politikë bërësit, zyrtarët publikë apo vendimmarrësit e tjerë, përmes takimeve personale dhe bindjes. Me lobim nënkuptohet një grup i organizuar njerëzish apo/dhe organizatash që punojnë së bashku për të ndikuar ligjvënësit ose zyrtarët e tjerë publik në vendimet e qeverisë lidhur me një çështje të veçantë, në favor të një kauze specifike.

Kur filloni punën për një iniciativë të re advokuese, gjithmonë duhet të organizoni një takim me një personat ose me institucionin. E rëndësishme është që në takim duhet të prezantoheni se kush jeni, çfarë bën organizata juaj dhe pse doni të organizoni një takim me vendimmarrësin. Kur kryeni negociatën dhe paraqitni pikëpamjen duhet të jini tepër i qartë. Nëse dakordsohet takimi duhet të përgatiteni seriozisht dhe të keni një plan të hollësishëm. Ndërkohë mendoni për zgjedhjen e mjeteve të duhura për të arritur qëllimet, objektivat dhe si të mobilizoni përkrahësit dhe në të njëjtën kohë si të neutralizoni kundërshtarët. Pra, lobimi është një strategji specifike e advokacisë për mbrojtjen e interesit publik apo privat, nëpërmjet ndryshimeve në legjislacion apo në problematika të tjera që prekin fushën e ruajtjes së natyrës. Lobimi përfshin komunikim të drejtpërdrejtë me vendimmarrësit dhe të tjerë që kanë ndikim mbi to. Lobimi ka të bëjë me edukimin dhe bindjen e tyre për të mbështetur dhe avancuar programin tuaj. Objektivat primare të lobimit janë njerëzit me fuqi për të ndikuar në një ndryshim të politikave në çështjen që keni marrë për shqyrtim.

Lobimi mund të ndodhë ose formalisht, përmes vizitave dhe informimeve të vendimmarrësve dhe të tjerëve, ose joformalisht, nëpërmjet bisedave në kohë, vende dhe rrethana më specifike në përshtatje me çështjen e advokim-lobimit. Që procesi i lobimit të jetë i suksesshëm duhet të zhvillohet mbi një program të mirë krijuar në kontekstin e çështjes dhe të rrethanave të veçanta.

Përvoja e disa OShC-ve ka qënë e përshtatshme, pasi kanë qënë në gjendje dhe kanë krijuar marrëdhënie të qëndrueshme midis organizatave të rrjetit, duke ndikuar në njohjen dhe zbatimin e standardeve dhe të legjislacionit për ruajtjen e natyrës dhe të përdorimit të baraspeshuar të burimeve dhe vlerave natyrore. Po kështu edhe diskutimet koka me koka me vendimmarrësit për t'i influencuar ata për të ndryshuar politikën, praktikën ose sjelljen.

Lobimi përfshin kontaktimin e ligjvënësve dhe përpjekjet për t'i bindur ata për të mbështetur ose refuzuar një politikë. Nëse ju jeni një përbërës individual ose një grup advokimi, kur takoni përfaqësuesit me një përpjekje për të nxjerrë një ndryshim të politikave, ju jeni duke i lobuar ata.

Lobimi është një pjesë e rëndësishme e çdo grupi avokatie që kërkon të bëjë një ndryshim dhe përfshin influencimin e njerëzve në pushtet të cilët mund të

ndikojnë në këto ndryshime. Ashtu si në çdo fazë të një fushate advokimi, edhe lobimi duhet të planifikohet në mënyrë strategjike për të ushtruar presionin e duhur ndaj përfaqësuesve tuaj dhe për të fituar një rezultat të favorshëm.

3.1. Teknika nën Llojet e Lobimit

Lobistët kryesisht përdorin dy lloje: Lobim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Lobimi i drejtpërdrejtë

Teknika më e fuqishme për lobim të drejtpërdrejtë është një takim ballë për ballë, sepse ju mund të flisni drejtpërdrejt për çështjet që prekin interesat tuaja dhe politikat që mund të ndihmojnë më mirë këto situata. Megjithatë, që kjo të funksionojë, është e nevojshme që së pari të ndërtohet një marrëdhënie pune me ligjvënësin e veçantë.

Teknika të tjera nën Lobimin e drejtpërdrejtë:

Marrja e telefonatave: kjo bëhet kryesisht nëse jeni duke punuar nën kufizime kohore. Ndërsa në një thirrje, jini konciz dhe të fortë dhe shpjegoni se çfarë është problemi i veçantë dhe si një politikë mund ta lehtësojë këtë çështje. Pyetja konsiston ku përfaqësuesi yt qëndron mbi çështjen dhe kërkon veprim.

Dërgimi i mesazheve dhe mesazheve elektronike: Ngjashëm me telefonatat, është e domosdoshme që mesazhi juaj elektronik të jetë i drejtpërdrejtë dhe konciz, me një vijë të qartë të temës në mënyrë që të mos injorohet. Bëni pyetje dhe kërkon veprime specifike; duhet të përfshihet edhe mënyra se si komuniteti do të përfitojë nga veprimi.

Një teknikë tjetër e drejtpërdrejtë e lobimit do të ishte që të zgjidhni persona me ndikim për t'u takuar, folur ose komunikuar me mesazh elektronik, pasi fjalët e tyre me siguri do të mbanin peshë.

Lobimi indirekt

Me lobim indirekt (ose grassroots), ju rritni ndërgjegjësimin për çështjet që grupi juaj i advokatisë dëshiron ta korrigojë dhe pastaj e përdorni këtë si një kanal për të ndikuar në qëndrimin e ligjvënësve. Teknikat që vijnë nën lobim indirekt janë:

Përdorimi i medias: Kjo zakonisht përfshin përdorimin e një sërë mediave të ndryshme për të krijuar ndikim në lidhje me një projektligj ose një politikë. Kjo përfshin përdorimin e kanaleve të shtypit, televizionit dhe në internet, si media sociale, për të ndikuar tek njerëzit që të krijohet një qëndrim për çështjen e ngritur.

Mobilizimi i njerëzve: Kjo përfshin organizimin e tubimeve, bojkoteve ose shqetësimeve për ose kundër një çështjeje. Ky është një mjet efektiv, pasi ai mbledh vëmendjen e intensive të medias dhe vendos presion mbi politikëbërësit.

Duke përdorur sondazhet e opinionit: Kur opinioni publik në lidhje me një projektligj është në përputhje me atë që lobistët duan të arrijnë, ata përdorin sondazhe për të hedhur vëmendjen mbi vendimet e ligjvënësve.

Teknikat e përbashkëta të lobimit dhe strategjitë për t'u përdorur

Kur lobon personalisht, ka disa këshilla që duhet të mbani në mend. Është një proces i trefishtë, që do të thotë, duhet t'i qaseni asaj nga një strategji që përfshin periodat para, gjatë dhe pas takimit tuaj në mënyrë që të maksimizojë përpjekjet tuaja të lobimit. Le të shikojmë disa teknika dhe këshilla për secilin.

1. Para takimit me personin me influencë

- Përgatisni literaturë për politikën që po synoni, duke përfshirë çështjet dhe shqetësimet që shpresoni të zgjidhni.
- Bëni kërkime sfondi për përfaqësuesin tuaj. Shikoni rekordin e tyre të mëparshëm me çështje të ngjashme dhe qëndrimet përkatëse që u morën. Kjo do t'ju japë një ide të drejtë se sa i suksesshëm do të jetë lobimi juaj.
- Programoni një njoftim përmes telefonit ose mesazhit elektronik të paktën një javë përpara se të filloni të takoni. Nëse nuk jeni në gjendje të kaloni në prezantimi tuaj, provoni të kaloni në stafin e tyre. Jini të sjellshëm dhe të patundur në kërkesën tuaj.
- Theksoni agjendën tuaj për takimin duke dërguar literaturën që keni përgatitur në mënyrë që përfaqësuesi ose zyrtari të ketë një ide të qartë se çfarë duhet të presë gjatë takimit.
- Rikonfirmoni paraprakisht mbledhjen tuaj në mënyrë që të mos jeni të prekur nga ndonjë ndryshim i minutës së fundit.

2. Gjatë Mbledhjes

- Jeni sa më të shkurtër sa të jetë e mundur. Përfaqësuesi ose zyrtari juaj ndoshta nuk do të ketë shumë kohë për të dëgjuar, kështu që të bëjë prezantimin e çështjes të drejtpërdrejtë dhe për pikën më të rëndësishme.
- Nëse po i referohemi një politike ekzistuese ose asaj që është në zbatim, referojuni atij me numrin dhe titullin e tij. Flisni përse doni që përfaqësuesi juaj të marrë një qëndrim të veçantë në lidhje me projekt-ligjin dhe se si do të përfitojnë zgjedhësit. Përdorni të dhëna dhe shembuj të vlefshëm për të mbështetur pikëpamjet tuaja.
- Një praktikë e mirë është të përmendim ligjvënës të tjerë ose organizata me ndikim që mbështasin qëndrimin tuaj. Kjo tregon se nuk jeni vetëm dhe se keni përkrahjen përkatëse.

- ➔ Jini të përgatitur për t'iu përgjigjur pyetjeve që do të vijnë në drejtimin tuaj; megjithatë, mos u shqetësoni nëse nuk e dini përgjigjen për një pyetje. Bëjeni të ditur që do t'iu ktheheni atyre më vonë me përgjigjen përkatëse.
- ➔ Pyetni drejtpërdrejt pyetje me përgjigje Po / Jo. Kjo siguron që në vend që të largoheni me një përgjigje jo përfundimtare dhe të tërhequr, ju e keni atë që menjëherë që përcakton nivelin e mbështetjes që keni prej tyre, nëse ka.
- ➔ Jini të përgatitur për dikë që është i vrazhdë ose në mënyrë të vendosur refuzon të përmbushë kërkesat tuaja.
- ➔ Lëri diçka të prekshme, si një kopje e vështirë e agjendës suaj, në mënyrë që mbledhja juaj të mos harrohet.
- ➔ Gjithmonë planifikoni një ndjekje në mënyrë që të jeni përditësuar në projektligj ose në çështje.

3. Pas takimit/mbledhjes

- ➔ Dërgoni pas takimit/mbledhjes një letër falënderimi ose një mesazh elektronik, edhe nëse çështja juaj nuk u mbështet domosdoshmërisht.
- ➔ Postoni rreth takimit tuaj në kanale të ndryshme, duke folur për rezultatin e arritur. Kjo u tregon organizatave të tjera ose njerëzve të përfshirë në të njëjtat çështje, nëse ata mund të mbështeten në bashkëpunimin e politikanëve apo jo.
- ➔ Nëse personi me influencë ble dakord të mbështesë kauzën tuaj, krijoni një strategji të bazuar në afatet kohore për mënyrën se si mund të punoni së bashku për të arritur qëllimet tuaja.

Lobimi mund të jetë një mjet shumë i dobishëm për ju si një grup advokimi ose një individ në arritjen e synimeve tuaja.

Kur takimi të përfundojë, sigurohuni që të lini broshura, fletë informacioni ose informacione të tjera të shtypura për referencë në të ardhmen. Një kujtim ndihmës, duke përmbledhur pikat kryesore të ngritura me vendim-marrësin, mund të jetë shumë i dobishëm dhe zakonisht vlerësohet nga partneri.

Katër hapat kyç do të ndihmojnë strategjinë e advokimit të avancojë nga lobimi përpara në negociata serioze:

1. Bëhuni të njohur me korridoret e pushtetit: Mësoni rreth sistemit, procedurave, afateve dhe liderëve dhe lojtarëve kryesorë.

2. Klasifikoni lojtarët: Gjeni se ku qëndrojnë në këtë çështje dhe sa ndikim kanë ata si vendimmarrës kyç ose për të bindur të tjerët.
3. Informimi dhe ndërtimi i marrëdhënieve: Nëpërmjet vizitave dhe përmbledhjeve të shkurtra ndihmoni objektivin me influencë që të kuptojë çështjet. Të fitoni besimin e tyre si një burim i besueshëm i analizës së cilësishë dhe si një përfaqësues i palëve të interesuara.
4. Merrni vëmendjen dhe tregoni fuqinë tuaj: Koha e medias, aktivitetet e kontaktit dhe mobilizimit në mënyrë që vendimmarrësit të jenë në dijeni të mbështetjes që qëndron pas propozimit tuaj.

3.2. Metodatat tjetra të lobimit

Metoda të tjera të lobimit përfshijnë peticione, letra, kartolina, mesazhe elektronike dhe telefonata. Këto metoda mund të përdoren vetëm, ose për të plotësuar vizitat e drejtpërdrejta me personin/nat qe keni planifikuar te takoni.

Peticione

Një peticion i nënshkruar nga shumë zgjedhës mund të ndihmojë në bindjen e një zyrtari/e ne detyrë për të marrë në konsideratë çështjen tuaj.

Peticionet mund të shpërndahen ose në kopje të shtypur ose në mënyrë elektronike (ka shumë faqe interneti falas, si GoPetition dhe PetitionOnline). Gjithashtu mund të printoni kopjet e marra elektronikisht dhe krijoni mundësinë për të ndryshuar peticionin (një kopje e shkarkueshme është në dispozicion në faqen e internetit).

Letra, kartolina dhe mesazhe elektronike

Letrat, kartolina dhe mesazhet elektronike të dërguara nga zgjedhësit janë mjete efektive të lobimit. Mos harroni, komunikimet që kërkojnë më shumë përpjekje llogariten për më shumë. Letrat personale mbajnë peshë shumë më tepër se letrat e formës dhe një kopje e vlefshme është më e vlefshme se sa një mesazh elektronik.

Kur i kërkonit dikë që të shkruajë një mesazh, jepni disa pika diskutimi dhe identifikoni pyetjen në mënyrë të qartë. Jepni një mesazh mostër, por kërkonit që ta personalizoni atë. Sigurohuni që t'i jepni ndonjë informacion të nevojshëm, ose lejoni të dijë se si ta gjejë (p.sh. emri i mbajtësit të zyrës, adresa e postës elektronike).

Bërja në një lokacion të zënë është një mënyrë e mirë për të mbledhur letra dhe kartolina; vetëm kërkojuni kalimtarëve të ndalojnë dhe shkruajnë një, dhe u thoni atyre se do ta dorëzoni më vonë. Mesazhet elektronike punojnë mirë kur u kërkojnë njerëzve të larguar fizikisht nga ju për të kontaktuar zyrtarët e tyre të zgjedhur.

Telefonata

Një telefonatë në përgjithësi mbart peshë më shumë se një mesazh elektronik, por mund të kërkohej me të njëjtën mënyrë (p.sh. përmes postës elektronike, Facebook, telefon). Kur paraqitni, ju gjithashtu mund t'i kërkonit njerëzve të bëjnë telefonata duke përdorur telefonat e tyre celularë (është mirë që secili person të përdorë telefonin e vet, meqë mbajtësit e zyrave zakonisht kanë telefonuesi).

Jepi çdo telefonuesi një dorëshkrim (dmth Një version mostër të asaj që duhet thënë). Gjithashtu i ofroni atij/asaj informacionin e sfondit mbi çështjen, emrin e zyrtarit të saj të zgjedhur dhe numrin që duhet thirrur.

Votimi

Nëse jeni duke kërkuar miratimin e një rezolute, humbja e një legjislacioni ose ndonjë akti tjetër ligjvënës, shtyrja juaj finale e lobimit do të vijë menjëherë para votimit. Në ditët e fundit, rritni përpjekjet tuaja. Nxitini njerëzit të bëjnë thirrje dhe të dërgojnë postë elektronike (edhe nëse e kanë bërë këtë më parë). Në disa raste do të mbahet një seancë publike e veçantë, ndërsa në të tjerat publiku do të jetë në gjendje të flasë në fillim të takimit legjislativ. Në secilin rast, merrni sa më shumë njerëz lokalë që mund të vini, në mënyrë ideale nga një sërë rrethe. Gjithashtu përpiquni të merrni individë me influencë (p.sh. drejtuesit e biznesit, donatorët) për të marrë pjesë. Kërkojuni disa individëve të mirëfilltë që të përgatisin dëshmitë dhe të flasin dhe pjesa tjetër të regjistrohen në mbështetje të pozitës suaj.

Nëse organi i zgjedhur voton në rrugën tuaj - festoni! Hidhe një festë ose një piknik dhe ftoj të gjithë ata që kontribuuan në përpjekjen për të marrë pjesë. Nëse nuk shkon në rrugën tuaj, le të njohin anëtarët tuaj rezultatit dhe festojnë fitoret më të vogla që keni arritur.

Pa marrë parasysh se çfarë ndodh, dërgoni karta falënderimi për çdo mbajtës zyre që votuan në mënyrën që ju e donit. Zyrtarët e zgjedhur janë si pjesa tjetër prej nesh: ata vlerësojnë se kanë njohur kontributet e tyre dhe do të kenë më shumë të ngjarë të punojnë me ju përsëri në të ardhmen, nëse ju falënderoni.

4. Ndryshimi midis advokimit dhe lobimit

Qëllimi i advokimit, lobimit dhe fushatës është i ngjashëm, por proceset janë të ndryshme.

Advokimi është çdo plan që përpiqet të ndikojë në politikë-bërësit dhe palët e interesit përmes aktiviteteve të dizajnuara për të rritur vëmendjen e publikut.

Lobimi është një lloj avokatie me qëllim të bindjes së qeverive dhe liderëve të saj për të marrë një qëndrim të veçantë rreth një legjislacioni të veçantë.

Megjithëse shumica e njerëzve përdorin fjalët në mënyrë të ndërsjellë, ekziston një dallim ndërmjet advokimit dhe lobimit që është i dobishëm për të kuptuar. Kur organizatat jofitimprurëse advokojnë në emër të tyre, ata kërkojnë të ndikojnë në ndonjë aspekt të shoqërisë, nëse u drejtohen individëve për sjelljen e tyre, punëdhënësit në lidhje me rregullat e tyre ose qeverinë për ligjet e saj. Lobimi i referohet në mënyrë specifike përpjekjeve të advokimit që përqipen të ndikojnë legjislacionin. Ky dallim është i dobishëm për t'u mbajtur mend sepse kjo do të thotë që ligjet që kufizojnë lobimin e bëra nga organizatat jofitimprurëse nuk qeverisin aktivitetet e tjera të advokimit.

5. Komunikimi dhe puna me median

Fushata ndërgjegjësuere është një seri iniciativash që kanë për qëllim ngritjen e interesit publik ose politik në një çështje specifike. Jep mesazhe bindese të bazuara në dëshmi dhe të orientuara drejt zgjidhjes për publikun, vendimmarrësit, palët e interesit dhe ata që i ndikojnë ato.

Mediat janë njëkohësisht një mjet dhe një objektiv për advokim për të ndërtuar një ambient për vlerësim të një çështje specifike. Mediat mund:

- Të luajë një rol kyç në ngritjen e vetëdijes dhe formimit të opinionit publik mbi përdorimin e provave në hartimin e politikave dhe përdorimin e vlerësimit për të nxitur llogaridhënien dhe transparencën.
- Të formësojë natyrën e debateve mbi rëndësinë e përdorimit të vlerësimit në hartimin e politikave të ruajtjes së natyrës.
- Të krijojë veprim nga politikëbërësit dhe ligj-zbatuesit për domosdoshmërinë e vlerësimit të një çështje specifike.
- Ndikimi mbi komunitetin, palët e interesuara dhe OSHC-të për të rritur kërkesën për vlerësimin e një çështje specifike, për të ndikuar dhe reaguar ndaj institucioneve përgjegjëse.

Në komunikimin me mediat mund të përdoren teknikat si deklarata për shtyp, konferenca, intervista dhe komente të ndryshme në studio apo dhe në teren.



Fuqizimi i Organizatave Mjedisore
të Shoqërisë Civile për të Promovuar
Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri

KËSHILLË

- Bëni bashkë një serë aktorësh dhe vendimmarrësish për të nxjerrë në pah shkaqet dhe identifikimin e zgjidhjeve për një problem të caktuar, të shoqëruar me ndjekjen e veprimeve konkrete dhe të menjëhershme.
- Mund të përcaktoni advokimin si një grup të koordinuar veprimesh për të ndikuar konkretisht në procesin e vendimmarrjes.
- Krijimi i politikave të qasjes në një mënyrë të shënjestruar, theksojnë rëndësinë e çështjeve. Këto pikëpamje mund të shprehen në konferenca apo/dhe duke shfrytëzuar ngjarjet e ndryshme të ndodhura.

P.S: Është e rëndësishme që roli i veçantë i mediave në arritjen e objektivave duhet të integrohet qartë në strategjitë e advokimi-lobimit.

5.1. Integrimi i medias sociale në punën e advokim-lobimit

Mjetet e medias sociale ofrojnë një gamë të gjerë mundësish për të rritur/ndikuar procesin e advokim-lobimit. Mediat sociale janë një mjet i lirë që mund t'iu ndihmojë të filloni një bisedë në një mjedis të përshtatshëm, me një numër të konsiderueshëm njerëzish. Një nga avantazhet e shumta të tij është se distanca është kryesisht e parëndësishme. Ndërsa disavantazhi kryesor i mediave sociale është se njerëzit mund të kenë qasje të kufizuara. Ashtu si me mjetet e tjera të advokimit, është e rëndësishme që të kemi një qëllim specifik dhe një audiencë të synuar para se të filloni me advokimin e mediave sociale.

Termi "media sociale" përmban një numër mjeteesh, secila me karakteristika dalluese. Përdorimi i shtuar dhe rëndësia e këtyre mjeteve ka sfiduar ndonjëherë të drejtën për lirinë e shprehjes dhe qasjen në informata që çojnë në një shkundje ndaj advokimit dhe fushatës. Krijimi i një plani për shfrytëzimin e mediave sociale është i nevojshëm dhe duhet të përfshijë:

- Çfarë doni të arrini? A është qëllimi juaj i veçantë (si ndryshimi i Politikës Kombëtare të Ruajtjes së Natyrës) apo i gjerë (ndërtimi programeve për mirëqeverisjen e zonave të mbrojtura dhe të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke angazhuar komunitet vendore, përdoruesit e tyre ose strukturat përgjegjëse menaxhuese dhe monitoruese)?
- Kush është audiencia që dëshironi të arrini? A komunikoni së pari me njerëz që tashmë janë të njohur me punën e OShC-së dhe partnerët? Apo po merrni në konsideratë objektivat dhe ndikimet që janë pjesë e strategjisë suaj të advokim-lobimit?
- Në cilat platforma të mediave sociale duhet të përqendrohemi? Ky vendim duhet të ndërmerret nga objektivi dhe audiencia e synuar.
- Çfarë materiale do të ndani përmes mediave sociale?

6. PRAKTIKA TË MIRA TË ZBATIMIT TË PROCESIT TË ADVOKACISË DHE LOBIMIT

6.1 RAST: Krijimi dhe funksionimi i rrjetëzimeve në Shqipëri

THEKSI: OSHC-të përdorim formën e krijimit të rrjeteve dhe koalicioneve për të forcuar zërin në çështjet që duan të advokojnë

Ndërtimi i një Shoqërie civile në gjendje për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore dhe ato të zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në Shqipëri, mbetet një sfidë tepër e rëndësishme.

Disa nga OSHC-të janë të qëndrueshme nga ana organizative, kanë burime të mjaftueshme dhe përvojë të konsoliduar, hartojnë dhe zbatojnë strategjikisht programet e projektet e tyre. Këto OSHC-të çojnë përpara çështjet lokale dhe kombëtare, sipas prioriteteve, përmes rrjetëzimit dhe veprimeve të përbashkëta. Rrjetet tematike adresojnë në mënyrë profesionale politikat mjedisore dhe njihen si aktorë të rëndësishëm nga ana e autoriteteve shtetërore.

OSHC-të apo/dhe QJF-të e vogla mundohen të jenë aktive në komunitetin e tyre, ndërmarrin nisma të përbashkëta me partnerët lokalë; janë ende jo të konsoliduara mirë, por bëhen më aktivet kur krijojnë rrjetëzim apo koalicione me partnerë të besueshëm.

Në rastin e organizatave të RrMN dhe të QJF-ve partnere u siguruan edhe disa praktika të mira në lidhje me promovimin dhe mirëqeverisjen e zonave të mbrojtura, biodiversitetin, peizazhin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, sepse:

E para, krijimi i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, i përbërë nga 8 organizata jo qeveritare, ishte real dhe rezultatet e këtij rrjeti janë të dukshme dhe të prekshme si gjatë zbatimit të programit SENIOR-A dhe II, por dhe në vijimësi;

E dyta, lidhet me hartimin e platformës së investigimit të zbatueshmërisë në praktikë të legjislacionit bazë të fushës së ruajtjes të natyrës, dhe

E treta, me identifikimin dhe ngritjen e një sistemi për adresimin e problematikave kryesore dhe të ndikimeve negative në zonat e mbrojtura mjedisore.

Në kuadër të zbatimit të projektit "Mbështetje për organizatat mjedisore të shoqërisë civile në Shqipëri (SENIOR-A dhe II), i cili u zbatua nga REC Shqipëri, me financim të Qeverisë Suedeze, mundësoj ndërtimin dhe funksionimin e rrjeteve tematike si më poshtë:

1. Rrjeti për tematikën: "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në Zonat e Mbrojtura":

- Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri - INCA;
- Shoqata "Green and Clean" - Korçë.
- Shoqata "Forum i Shqiptar Liqeni i Shkodrës" - Shkodër.
- Shoqata "Qendra Adriatiku" me pas "FlagPine" - Vlorë.
- Shoqata "Miqësia, Ulëz" - Ulëz.
- Shoqata "PSEDA – ILIRIA" - Tiranë.
- Shoqata "Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimit të Turizmit", Qarku Kukës - Kukës.
- Shoqata "Mjedisore Çajupi" - Gjirokastrë.

2. Rrjeti për tematikën: "Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve mjedisore nëpërmjet "Teknikave të Vëzhguesve të Trajnuar":

- Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) - Tiranë.
- Shoqata "AULEDA - Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal" - Vlorë.
- Shoqata "Fondacioni Gjirokastra" - Gjirokastrë.
- Shoqata "Tjetër Vizion" - Elbasan.
- Shoqata "Unë, Gruaja" - Pogradec.
- Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të ardhmen" - Durrës.
- Shoqata "Instituti për Politika Publike dhe Ndryshim Social" - Krujë.

3. Rrjeti për tematikën: "Informim - Komunikimi mbi politikat mjedisore për zhvillim të qëndrueshëm, me fokus të veçantë menaxhimin e mbetjeve urbane":

- Qendra "Grupimi Ekolëvizja" - Tiranë.
- Qendra "Agjencia AJMMI" - Sarandë.
- Shoqata "Ekomjedisi Durrës" - Durrës.
- Shoqata "Forum i Mendimit të Lirë" - Tiranë.
- Shoqata "Milieukontakt Shqipëri" - Tiranë.
- Shoqata "Edukim Social dhe Mbrojtja e Mjedisit (SEEP) - Vlorë.
- Shoqata "Together for Life".

4. Rrjeti për tematikën: "Së bashku një sy për mjedisin":

- Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN) - Tiranë.
- Shoqata "Klubi Ekologjik" - Elbasan.
- Shoqata "Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore" - Berat.
- Qendra e Informacionit Aarhus - Shkodër.
- Qendra për Kërkim, Bashkëpunim dhe Zhvillim (CRCD) - Tiranë.
- Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania) - Tiranë.

a. Forumi Lokal Mjedisor (FoLM)

INCA, bazuar në angazhimet e marra, drejtoj procesin për të krijuar rrjetin e këshilltarëve lokal, për një qasje më të mirë të ruajtjes së natyrës, përmirësimin e menaxhimit të ZMM-ve dhe të mirëpërdorimit të burimeve natyrore; për identifikimin e mangësive dhe të ndikimeve negative, të informimit të publikut si dhe të rritjes së reagimit të tyre ndaj strukturave shtetërore, qendrore e lokale, përgjegjëse për gjendjen e krijuar.

FoLM do të shërbejë si një strukturë lokale profesionale e gatshme për të marrë pjesë në proceset advokuese dhe këshilluese pranë strukturave vendore përgjegjëse për ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Për këtë: secila prej organizatave të RrMN nxiti krijimin e forumeve mjedisore lokal, në nivel qarku, që do të vlijojë procesin e advokim-lobimit për çështjet e ruajtjes së vlerave dhe burimeve natyrore dhe adresimin e problemeve dhe të impakteve negative që prekin ZMM-të.

Krijimi i forumeve lokale mundëson: (i) Uljen në një tryezë të të gjithë palëve të interesuara dhe që kanë interes në ZMM-të (ii) Për të diskutuar çështjet që lidhen me mjedisin dhe burimet natyrore për zonën; (iii) Adresimin e problematikave dhe të nevojave më mirë, të drejtpërdrejt dhe në mënyrë të rregullt formale.

b. Bordi i Përbashkët Këshillues (BPK) Vendor për Zonën Ndërkufitare Korab-Koritnik/Sharr-ŠarPlanina

Krijimi i BPK-s ishte rrjedhojë e Deklaratës së Vizioneve të Përbashkëta të tre ministrave të Mjedisit të tre shteteve, për të cilin u angazhua INCA, sipas projektit "Shërbimet e Ekosistemit Ndërkufitar", të mbështetur nga GIZ. Objekti kryesor i këtij procesi ishte krijimi i një mekanizmi ndërkufitar bashkëpunimi, dhe ngritja në të ardhmen të një strukture të përbashkët menaxhimi për zonën trepalëshe. Për arritjen e këtij objekti puna e INCA-s u përqendrua tek bashkimi i grupet të interesit nga të tre vendet me synim: a) Prezantimin dhe vlerësimin e situatës aktuale të bashkëpunimit ndërkufitar në zonën trepalëshe; b) identifikimin e problemeve ekzistuese; c) për të ndarë idetë dhe praktikat më të mira për përmirësimin e situatës dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes tri vendeve në të ardhmen.

Bordi përbëhet kryesisht nga përfaqësues të komuniteteve vendase dhe palët e interesit, si dhe nga organizata të tjera. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërmjet anëtarëve pjesëmarrës dhe joanëtarëve, që krijojnë sinergji me institucionet e tjera në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, përfshirë edhe donatorët, me qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të Zonës Ndërkufitare; duke forcuar bashkëpunimin harmonik për natyrën dhe zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet pjesëmarrjes publike aktive dhe respektimit të nevojave dhe aspiratave të komuniteteve vendase.

Për funksionimin e këtij grupi ndërkufitar u hartua dhe u miratua Statuti i tij, ku Bordi i Përbashkët Këshillues (BPK).

c. Disa nga grupime të tjera funksionale në Shqipëri:

1. Grupimi *"Të mbrojmë lumenjtë"*.

- Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)
- Qendra EDEN
- ILIRIA
- Milieukontakt Albania
- Qendra Mjedisore për Edukim Zhvillim dhe Rrjetëzim (EDEN)
- Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)
- Qendra "Grupimi Ekolëvizja"
- Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit (ETMI)
- Shoqata e Bujqësisë Organike (SHBO)
- Shoqata TOKA Valbonë.

2. Në kuadër të fushatës *"Të Shpëtojmë zemrën blu të Evropës"*, krijohet Grupimi *"Të shpëtojmë Vjosën"*.

3. Grupimi *"Të shpëtojmë Alpet Shqiptare"*.

4. Grupimi *"Ndal ndërhyrjeve në parkun kombëtar të Divjakë-Karavastasë"*.

5. Koalicionin *"Stop Urbanizimit të Parkut Kombëtar "Divjakë-Karavasta"*.

6. Rrjeti *"Aleanca e Ligatave Mesdhetare"*.

6.2 RAST: Identifikimi i problematikave kryesore të mirëqeverisjes së zonave të mbrojtura mjedisore

THEKSI: Përvoja e INCA-s dhe e Rrjetit të Ruajtjes së Natyrës, në Shqipëri.

Sfida në fushën e mbrojtjes së natyrës u fokusuan në krijimin e një ekspertize të mirë për të përmbushur qëllimin kryesor dhe objektivat specifike të rrjetit për ruajtjen e natyrës. Në këtë drejtim INCA hartojë dhe më pas zbatojë një metodologji për "Identifikimi i problematikave kryesore të administrimit të zonave të mbrojtura, perceptimi i rolit të Organizatave të Rrjetit të Mbrojtjes së Natyrës (ORRMN) dhe të DJF-ve partnere si dhe diskutimi në publik", e cila merret në konsideratë procesin e grumbullimit dhe analizimit të fakteve të mbledhura si dhe tërheqjen e vëmendjes publike drejt problematikave kryesore me të cilat përballen ZMM-re.

Nëpërmjet bashkëbisedimeve me palët e interesuara dhe me zbatimin e një metodologjie (pyetësor/individual) efektive, ku u identifikuan dhe u trajtuan, në përgjithësi dhe veçanti, mangësitë kryesore dhe vlerësimi i tyre në lidhje me njohjen e problematikave aktuale që shqetësojnë dhe shoqërojnë ruajtjen, administrimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore.

Me këtë vlerësim, më pas dhe analizimin e problemeve të shkaktuara, krahas adresimit u synua që të arrihej qëllimi për tërheqjen e vëmendjes publike drejt problematikave kryesore me të cilat përballen zonat e mbrojtura mjedisore, rritjen e reagimit ndaj tyre si dhe caktimin e rekomandimeve përkatëse për minimizimin e ndikimeve negative.

Vlerësimi parashtroj një model zhvillimi afatgjatë për ZMM-të, duke paraqitur rastet pozitive të menaxhimit, efektet pozitive të reformave gjatë këtyre viteve, rekomandimet profesionale, të paanshme, të ekuilibruara, gjithëpërfshirëse, mbi mundësitë e përdorimit të qëndrueshëm dhe rikuperimit të burimeve dhe zbatimit të parimeve të menaxhimit të mjedisit natyror, bazuar në menaxhimin e integruar dhe të qëndrueshëm si dhe një plan veprimi lidhur me arritjen e targeteve të planifikuara.

Veprimtaria e pakontrolluar njerëzore, për vite radhazi, ka shkaktuar një stres të fuqishëm në ZMM-të, i cili ka pasur një ndikim të shoqëruar me dëme të mëdha me natyrë të theksuar demografike dhe ekologjike. Intensiteti i këtyre ndikimeve përcaktohet ndjeshëm nga faktorë social-ekonomike të tillë si rritja e popullsisë apo shpopullimit të zonave rurale, bujqësia, blegtoia dhe praktikat jo të mira të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave.

Në analizën dhe vlerësimin e shqetësimeve iu dha rëndësi dhe marrjes parasysh të disa efekteve antropogjene. Hartografimi i presioneve dhe kërcënimeve ndaj zonave të mbrojtura ekzistuese dhe ekosistemeve të pambrojtura, njëherazi shërben edhe për të identifikuar/përcaktuar veprimet emergjente që duhen marrë për kërcënimet ndaj sistemit të zonave të mbrojtura të vendit.

Përvoja e këtyre viteve për QShC-të kërkon një angazhim më të madh për adresimin e problematikave dhe të reagimin ndaj tyre. Krahas vijimit të procesit të ngritjes së kapaciteteve të tyre, të promovimit të natyrës, të forcimit të rolit dhe të rritjes së bashkëveprimit konkret me komunitetet, palët e tjera të interesuar, duhet të ndërmarrin iniciativa dhe të përfshihen më mirë në advokim-lobim-reagim për ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në nivel lokal dhe qendror, duke rritur presionin dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore, nëpërmjet pjesëmarrjes, sensibilizimit dhe informimit e anëtarëve të këshillave bashkiake si dhe në komisionet përkatëse lokale, rajonale dhe të Kuvendit të Shqipërisë.

E parë në kuadër të analizave dhe synimeve strategjike që kërkohen rezultojnë se ka ende shumë punë për të bërë, në drejtim të forcimit të kapaciteteve, të

rritjes së pavarësisë, të ngritjes së rolit të tyre për adresimin e problemeve dhe të ndikimeve negative në strukturat lokale e qendrore, sipas përkatësisë, për përmirësimin e situatës, të gjendjes mjedisore e të jetesës së banorëve, duke promovuar dhe zhvilluar veprimtari që sjellin një ndikim pozitiv në komunitet. Njëkohësisht, OShC-ve të rrjetëzuara, iu këshilluam dhe i inkurajuar dialogun për qeverisjen dhe zhvillim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, përmes pjesëmarrjes dhe partneritetit. Shoqëria civile është vlerësuar si platformë e veprimit vullnetar kolektiv për interesa, qëllime dhe vlera të përbashkëta në shoqëri. Për këtë arsye, fuqizimi i rolit të shoqërisë civile është objektiv i rëndësishëm.

Të gjitha impaktet e identifikuara janë shqetësime të banorëve dhe të përdoruesve të burimeve natyrore, të administratave përkatëse, të cilët kanë marrë pjesë aktive në hartimin dhe miratimin e listës së ndikimeve negative. Për mënjanimin e këtyre dukurive është e domosdoshme pjesëmarrja dhe fuqizimi i rolit të komunitetit apo dhe i grupeve të interesit, në proceset vendimmarrëse, me qëllim të krijimit ose përmirësimit të politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit të mirëqenies së qytetarëve, të promovojnë përgjegjësinë, rrisin besimin dhe të forcojnë përkushtimin drejtë përmirësimit të qeverisjes dhe të kufizojnë praktikën korruptive.

Pjesëmarrja qytetare ka synim bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve në mes institucioneve, shoqërisë civile, sektorit privat dhe publikut në përgjithësi. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në qeverinë lokale shpesh përdoret si indikator për të vlerësuar nivelin e demokracisë dhe respektimit të ligjit në institucionet e shtetit. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve kërkon, informacione, aftësi, mjete financiare dhe kohë. Praktika e deritashme ka dëshmuar se qytetarët janë më shumë të interesuar për pjesëmarrje në vendimmarrje lokale, në rastet kur vendimi prek drejtpërdrejt interesat e ngushta të tyre.

MJETET E PËRDORURA:

- Planet e menaxhimit të Zonave të Mbrojtura.
- Raporti i Gjendjes në Mjedis - AKM.
- Raporte të analizave të kryera nga AKZM.
- Raport "Arritjet dhe mangësitë në ruajtjen e natyrës, të ZMM-ve dhe të biodiversitetit në Shqipëri".
- Raporte të OShC-ve për problemet mjedisore dhe të mirëqeverisjes së burimeve natyrore.
- Platformë "Për analizimin dhe investigimin e legjislacionit ekzistues për ruajtjen e natyrës si dhe për të monitoruar e raportuar zbatimin e tij në praktikë".
- Udhëzim "Për trajnimin dhe përforcimin e kapaciteteve të OShC-ve në analizimin e legjislacionit ekzistues për ruajtjen e natyrës si dhe për të monitoruar e raportuar zbatimin e tyre në praktikë".

- Metodologjia "Identifikimi i problematikave kryesore të administrimit të zonave të mbrojtura, perceptimi i rolit të OMSHC-ve dhe diskutimi në publik";
- Investigimi nëpërmjet përdorimit të pyetësorëve me komunitetin dhe palët e tjera të interesit për biodiversitetin, ZMM-ve dhe burimet natyrore.
- Takime, konsultat dhe seminare me komunitetin, OJF-të mjedisore lokale, individë dhe grupet e përdoruesve/subjektet, si dhe palët e tjera të interesit për shfrytëzimin e vlerave të biodiversitetit dhe të burimeve natyrore.

Së fundmi, ky mjet dhe analiza e hartëzimit të impakteve negative në ZMM-re do t'iu ndihmojë në strategjinë e fushatës së advokim-lobimit, sipas specifikave që keni apo do të identifikoni në zonat e interesit.

6.3 RAST: Promovimi dhe ruajtja e natyrës dhe e burimeve natyrore

THEKSI: Aksione të ndryshme të grupimeve të OSHC-ve me fokus mbrojtjen e natyrës

Mbrojtja e natyrës, pjesë e politikave dhe strategjive mjedisore, është përmendur vazhdimisht si një nga drejtimit kryesore, megjithëse gjendet e shpërndarë në disa aspekte si biodiversiteti, zonat e mbrojtura, pyjet, burimet peshkore, shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve dhe peizazhit natyror, etj., të cilat në një formë ose tjetër janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën.

Në studimin e kryer për investigimin e problematikës së ruajtjes, menaxhimit dhe përdorimit të burimeve natyrore, në zonat e mbrojtura, u përzgjedhën OJF-të mjedisore me të cilat u formësuan rrjetëzimet lokale. Me këto shoqata u zhvilluan trajnime mbi njohjen e legjislacionit për fushën e ruajtjes së natyrës, mënyrat e investigimit në terren dhe plotësimin e një pyetësori investigues, të parapërgatitur. Nga investigimi i kryer dhe një shikim të përgjithshëm në zonat e mbrojtura, u vu re, lehtësisht, se ndërhyrjet njerëzore kanë ndikuar në prishjen e baraspeshës ekologjike të natyrës, kjo si rrjedhojë edhe e mos njohjes së statusit të ZMM-ve.

Nga pikëpamja ligjore dhe institucionale, ka përpjekjeje dhe arritje drejtë standardeve evropiane, por problem mbetet forcimi i zbatimit të ligjit në fuqi dhe i kompetencave përkatëse të AdRZM-ve, të Bashkive dhe inspektorateve. Menaxhimi i ZMM-ve ende nuk është në standardet e kërkuara, me gjithë përpjekjet që po bëhen pas krijimit të AKZM-së.

Situata aktuale ende nuk reflektohet në realitet në mënyrën si ato ruhen dhe menaxhohen; kjo është e lidhur edhe me stafin e angazhuar për këtë çështje. Mosnjohja sa duhet dhe zbatimi i dobët i legjislacionit dhe menaxhimi joefektiv

i aplikuar në praktikë, vazhdojnë të mbeten shqetësimet kryesore të ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit në Shqipëri.

Investigimi i kryer në zonat e mbrojtura nxori në pah se, megjithëse janë hartuar planet e menaxhimit, ato nuk disponohen nga administratat përkatëse të ZMM-ve. Po kështu nuk hartohet plani vjetor i punës mbi bazën e programeve dhe të aktiviteteve të parashikuara në planin e menaxhimit, gjithashtu vërehet dhe mungesa planifikimit dhe e mbështetjes me fondet përkatëse.

Shumica e burimeve natyrore janë nën kërcënimin e presioneve të vazhdueshme si: prerjet e paligjshme e pyjeve, gjuetia, mbi peshkimi; erozioni, degradimi i tokës, zjarret, keqmenaxhimi i ujërave; shfrytëzim dhe përdorim të pakontrolluar të burimeve natyrore; mbledhja e bimëve mjekësore, tanifere dhe eterovajore me mënyra, metoda e në periudha të ndaluara; shqetësimi dhe përndjekja e kafshëve të egra në natyrë, zhdukje llojesh apo kërcënim për zhdukje, kapja, për qëllime tregtimi e kafshëve dhe e shpendëve të rrallë dhe të rrezikuar; turizmi i pakontrolluar dhe menaxhim joefektiv i veprimtarive rekreative, argëtuese dhe sportive; zënie dhe ndërtime të paligjshme, veçanërisht HEC-ve, çelja e gurorëve, instalimi i impianteve pranë ZMM-ve, duke dëmtonuar peizazhin dhe imazhin e tij; ndotja e mjedisit, mostrajtimi i ujërave të zeza dhe të përdorura; menaxhimi i pa kontrolluar i territorit, ndërtimet kaotike dhe infrastruktura; vëmendja e pakët ndaj peizazhit; mungesa e menaxhimit të integruar dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore si dhe e alternativave për zëvendësimin e tyre, etj.

Strukturat qendrore dhe lokale, që merren me ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore dhe elementëve të biodiversitetit, menaxherët, AdZM dhe aktorët të tjerë lokal, shpesh nuk kanë njohuritë, aftësitë dhe infrastrukturën e nevojshme për të arritur një menaxhim efektiv të ZM dhe të burimeve natyrore.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore nuk është i integruar ende si duhet në politikat lokale. Përfshirja e komuniteteve lokale, në ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, ka ende një rrugë të gjatë për të kryer. Këta komunitetet lokale, në shumicën e rasteve, nuk arrijnë të prekin përfitimet socio-ekonomike që rrjedhin nga menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në zonat e mbrojtura. Mos përfshirja dhe ndarja jo e drejtë e përfitimeve vjen përgjithësisht si pasojë e kapaciteteve të ulëta dhe mungesës së njohurive në grupet e komunitetit lokal dhe mungesës së koordinimit midis organizatave të shoqërisë civile që i përfaqësojnë. Aktualisht, kjo situatë pengon zbatimin efektiv të politikave të ruajtjes së mjedisit dhe natyrës, dhe lehtësisht çon në konflikte dhe keqkuptime, veçanërisht me komunitetet lokale, të cilat jetojnë në rajonet me vlerat më të larta të biodiversitetit në vend.

OSHc-të, si struktura të rëndësishme për të ndërmjetësuar pjesëmarrjen e suksesshme të publikut në procesin e vendimmarrjes, janë të nevojshme për të siguruar që mendimet dhe pikëpamjet e tyre të merren në konsideratë. Nga

të dhënat e siguruara gjatë kryerjes së investigimit në ZMM-re, vërehen ende mangësi e theksuar për funksionimin e tyre. Duhet pranuar që OJF-të lokale nuk janë në standardet e kërkuar, ku ndër të tjera vërehet mungesë e mjeteve të punës dhe të komunikimit, të mos pasjes së legjislacionit për fushën e ruajtjes së natyrës, të angazhimit të stafit dhe anëtarëve të tyre si dhe të mënyrës së bashkëveprimit me banorët, institucionet përgjegjëse, komunitetet e biznesit, etj. E njëjta situatë mund të thuhet edhe për strukturat përgjegjëse në AdRZM-ve dhe kryesisht të bashkive.

Në këtë drejtim duhet të ndërmerren iniciativa duke i përfshirë më mirë OShC-të në monitorimin dhe në procesin e advokim-lobimit të problematikave të ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit në nivel lokal dhe qendror, duke rritur njëherazi presionin dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore, nëpërmjet sensibilizimit, promovimit dhe trajnimit e banorëve, komuniteteve, shkollave, pse jo dhe të anëtarëve të këshillave bashkiake.

Në zbatim të projektit “Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri”, INCA, mbështetur në objektivat specifik synon të rrisë dhe fuqizojë aftësitë dhe rolin aktiv të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në zbatueshmërinë e legjislacionit, në luftën kundër korrupsionit dhe minimizimin e ndikimeve negative në menaxhimin e burimeve natyrore dhe të zonave të mbrojtura si dhe të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve dhe autoriteteve publike, komuniteteve lokale dhe mediave dhe të nxisë rrjetëzimin dhe ndërtimin e partneritetit mes tyre, në krijimin e një programi pune afatgjatë me fokus përmirësimin e detyrimit të zbatimit të legjislacionit kombëtar dhe acquis-ve të BE-së në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Ndërkohë, INCA, ka rekomanduar, që OSHC-të lokale në RN “Kune-Vain-Tale”, PK “Divjakë-Karavasta”, PK “Shebenik-Jabllanicë” dhe ZNM “Gjiri i Porto Palermos” të krijohen partneritete apo/dhe koalicione me OJF-të mjedisore apo dhe individë me ndikim e influencë për zbatimin e aktiviteteve të parashikuar për fushatat e advokim-lobimit.

Njëherazi nëpërmjet këtyre grupimeve do të arrihet që OSHC-të e synura të forcojnë njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet e tyre për t’u angazhuar në advokim-lobim dhe në proceset vendimmarrëse me një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, efektive dhe të barabartë të të OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë kryesorë joqeveritarë, për ruajtjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, duke përmirësuar aftësitë e tyre organizative dhe rrjetëzuese.

Kësisoj, në përgatitjen e strategjisë apo/dhe të planit të veprimit të fushatës së advokim-lobimit, Ju mund të përdorni si referencë përvojën dhe analizat e kryera nga INCA dhe RrMN, si në rastet studimore të mëposhtme:

1. Vlerësimi, Analizimi dhe Hartëzimi i Impakteve Negative në ZM.

2. Metodologjia – Identifikimi i problematikave kryesore të administrimit të zonave të mbrojtura, perceptimi i rolit të OMSHC-ve dhe diskutimi në publik.
3. Vlerësimi i gjendjes së problematikave mjedisore dhe të zonave të mbrojtura në Shqipëri.
4. Legjislacioni bazë dhe mbështetës mjedisor për menaxhimin e zonave të mbrojtura.
5. Udhëzues "Për mënyrat më të mira të komunikimit, advokimit, lobimit dhe pjesëmarrjes publike".

Këto analiza dhe raporte i gjeni: www.inca-al.org/publikimet

6.4 RAST: Ndërmarrja e veprimeve konkrete dhe të rritjes së përgjegjësisë për mbrojtjen e natyrës, të burimeve dhe të peizazhit natyror.

THEKSI: Reagimet e grupimeve të OSHC-ve për mbrojtjen e natyrës nga ndikimi i ndërtimit të HEC-ve

Shoqëria civile dhe organizatat jo fitimprurëse prej kohësh kanë ngritur zërin për të mbrojtur dhe shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme burimet ujore të vendit dhe kryesisht ato të lumenjve. Jemi dëshmitar të një sulmi të pa precedent që i është bërë rrjetit hidrik të vendit, ku janë dhënë mbi 540 leje shfrytëzimi për ndërtimin e hidrocentraleve, me një përfitim tepër minimal energjetik, në raport me dëmin mjedisor që ato shkaktojnë.

Shqipëria përballlet me sfidën e dyfishtë, nga njëra anë për të përshpejtuar rritjen ekonomike dhe njëkohësisht për të mbrojtur mjedisin, por, në mjaft raste, janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Zhvillimi i qëndrueshëm, financimi i qëndrueshëm dhe investimet, nënkuptojnë rritje gjithëpërfshirëse në lidhje me mjedisin dhe mbrojtjen sociale.

Komisioni Evropian (KE) dhe më shumë Parlamenti Evropian (PE), kanë nënvizuar shqetësimin e thellë për disa projekte që kanë çuar në dëmtime të rënda mjedisore në zonat e mbrojtura, siç janë vendpushimet turistike në shkallë të gjerë dhe hidrocentralet përgjatë lumenjve Vjosa dhe Valbona, etj. Shqipëria duhet të planifikojë hapat e saj të ardhshëm të zhvillimit, bazuar në këto platforma të rëndësishme. Ajo duhet të zbatojë përpjekjet e saj për mjedisin dhe ndryshimin e klimës, i cili gjithashtu lidhet me çështjet e energjisë dhe zhvillimit. Përbushja e kriteve dhe të rregullave të BE mund të jetë një rrugë treguese përpara dhe asistencë e BE-së duhet të përdoret në një kohë dhe në mënyrë të qëndrueshme. Një strategji kombëtare dhe legjislacion mbi ndryshimet klimatike, cilësia e ajrit, mbrojtja e parqeve kombëtare dhe

pellgjeve lumore janë vetëm disa nga çështjet që janë të nevojshme, si dhe domosdoshmërinë për adoptimin dhe zbatimin real të legjislacionit.

Vendimet përkatëse duhet të kenë disa karakteristika strukturore: të jenë rezultat i konsultimit me komunitetet lokale dhe shoqërisë civile, të bazohen në vlerësime të besueshme të ndikimit në mjedis, të jenë pjesë e një strategjie tërësore për zhvillim të qëndrueshëm, nga i cili të gjitha pjesët e shoqëria do të përfitojnë, duke u marrë me pabarazitë e sotme në rritje.

Rastet e studimit, të OShC-ve shqiptare, në bashkëpunim me ato rajonale e ndërkombëtare, tregojnë se dokumentacioni dhe procedurat e ndjekura për "Vlerësimin e ndikimit në mjedis" në shumicën e rasteve nuk përkojnë me standardet ligjore të BE-së. Efektet e para negative të vërejtura (mangësia e ujit, turbullira e shkaktuar, erozioni tokësor, dëmtimet e faunës, etj) dhe reagimet e komuniteteve lokale janë dëshmitë e pasojave të prirshme që do të kenë shpejt pasoja shumë herë më të rënda në mjedis dhe në mirëqenien e popullatave në këto basene.

Ndërtimi i HEC-ve në Shqipëri, mund të shkaktojë dëmtime të pakthyeshme mjedisore dhe të ndikojë tek zhvillimi ekonomik dhe ai shëndetësor. Kjo çështje ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, por edhe me varësinë e energjisë, mungesën e konsultimeve me komunitetet lokale, të drejtat e pronësisë, zhvillimin e shëndoshë ekonomik.

Një shembull karakteristik është ndërtimi i shumë HEC-ve në zonat e mbrojtura. Shqipëria, ka shkelur shumë rregulla për sa i përket ndërtimit të tyre. Shumë lumenj janë në rrezik shkatërrimi dhe për këtë fakt qeveria shqiptare hesht, megjithëse ka miratuar një numër të madh koncesionesh në këtë sektor. Kjo u theksuar dhe në konferencën e 7 Marsit 2019, në PE, me titullin "Ruajtja e lumenjve të Ballkanit - Rezistenca ndaj hidrocentraleve në Ballkan dhe Shqipëri", organizuar nga Grupimi i Të Majtës së Bashkuar Evropiane dhe Grupimi i Të Majtëve Verior të Gjelbër, (GUE/NGL) (SPE), Jakovçiç (ALDE) dhe Waitz (Gjelbrit).

Në përfundim të konferencës,deklarata theksoj se: "Evropa Juglindore ka një mjedis të veçantë me një biodiversitet unik që duhet të mbrohet". Megjithatë, që nga viti 2005 janë planifikuar më shumë se 2112 Hidrocentrale, të cilët shkaktojnë dëme të pakthyeshme në mjedis. Shumë prej tyre janë të vendosura në zona të mbrojtura dhe mjedisore të ndjeshme dhe parqe kombëtare.

PE dhe raportet e KE kanë theksuar se studimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis janë të hartuara keq dhe nuk sigurojnë pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin përkatës të BE-së. Për më shumë se një dekadë qytetarët, aktivistët dhe shoqëria civile nga Ballkani kanë zhvilluar një luftë kundër HEC-ve, duke nënvizuar se këto projekte përbëjnë një kërcënim për mjedisin, zhvillimin e qëndrueshëm dhe në fund të fundit në mënyrën e tyre të jetesës.

Reagimi i Deputetit të Grupimit të të Gjelbërve, Thomas Waitz.

Në konferencë theksoj se Qeveria në Shqipëri po vret trashëgiminë natyrore. Njëherazi solli fakte se nuk janë përgjegjëse vetëm kompanitë e ndërtimit, por edhe Bankat, të cilat japin hua për këto projekte, si në rastet e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Po të shikojmë një analizë krahasuese rezulton se të ardhurat nga turizmi malor dhe turistik janë shumë herë më të mëdha se nga ndërtimi i HEC-ve. Por si është e mundur që qeveritë në Maqedoninë e Veriut, në Shqipëri, Kosovë apo Serbi, janë gati për të shkatërruar trashëgiminë e tyre natyrore. Kjo situatë është e lidhur me korrupsionin. Kush nga ju e di se si të gjitha investimet shkojnë për planet e HEC-ve. Kjo është industria konkrete e cila lobon përmes tarifës dhe tundimit. Ne flasim vazhdimisht për të ardhmen e natyrës, madje harxhojmë edhe miliona për këtë çështje, por më pas japim hua për të shkatërruar ato që ne duam t'i mbrojmë. Kjo vetëm sepse këto vende nuk janë anëtare të BE-së.

Reagimi i organizatave RiverWatch & EuroNatur.

Janë organizata të lidhura shumë me lumenjtë, në rajonin e Ballkanit, për afro 6 vjet si dhe janë përballur me çështjen e HEC-ve. Në raportin e KE-së për çështjen e zgjerimit, këto vende janë kritikuar për shpërhapjen e pakontrolluar të projekteve mbi energjetikën, andaj këto organizata kanë paraqitur një master planin për ekosistemin e Ballkanit. Kjo për faktin se lumenjtë e Ballkanit përbëjnë hapësirën më të madhe të paprekur dhe kanë vlera të mëdha. Nga të dhënat, rezulton se çdo pjesë e këtyre lumenjve është nën kërcënim. Shqetësuese është gjendja në Drinin e zi, në Shqipëri. Vetëm kohët e fundit, një pjesë e mirë e këtij lumi është tharë. Ky është vetëm një shembull për planet e HEC-ve, por një pjesë e madhe e tyre do të ngrihen ose janë ngritur në zona të mbrojtura. Mbi 100 prej tyre janë ndërtuar në parqet kombëtare dhe në zona të kategorisë së mbrojtur. Por nga ana tjetër, protestat në rritje mund të shikohen si një kërcënim për klimën e investimeve në Shqipëri. ajo që ne mund të themi është thjesht ndalimi i këtyre ndërtimeve dhe të fokusohen tek zhvillimi dhe jo vetëm në letër. Ligji nuk është i keq, por implementimi i tij është i dobët”.

Reagimi i WWF-Adria.

Situata e vështirë në lidhje me procesin e ndërtimit të HEC-ve në lumenjtë e Ballkanit Perëndimor ka shqetësuar organizatat të cilat merren me ruajtjen e trashëgimisë së mjedisit natyror dhe të dëmeve që sjellin për natyrën dhe ekonominë e një vendi. Ndër të tjera theksoi se kemi dëgjuar që procesi i hidroenergjetikes është një burim për zhvillimin e ekonomisë. Kjo është vetëm një propagandë. Energjia e gjelbër sjell përfitim për njerëzit, për zhvillimin e qëndrueshëm, të cilat janë të mira për natyrën, por duke iu parë të gjithë Ju dhe duke iu dëgjuar, çfarë mendoni Ju, është një burim energjia e gjelbër apo jo?

Reagimi i Green Home (Montenegro).

Implementimi i ligjit në Malin e Zi është shumë i vakët. Ka shumë lumenj, që po dëmtohen. Njerëzit janë në dyshim dhe të prekur nga kjo gjë. Të paguash diçka e cila po shkatërron natyrën është e pa tolerueshme. Kjo është një hipokrizi. Nuk ka plane të mirëfillta për këto çështje. Nuk ka strategji për ndërtimin e tyre. Madje ne si shtet nuk kemi as një kadastër të madhe për ujin. Mund të ketë pasur disa studime, por ato nuk janë publikuar kurrë. Pra, kjo është e njëjtë edhe për vendet e tjera, çfarë kanë ata atje.

Ka shumë njerëz të cilët po protestojnë për këtë çështje. Ka 88 kontrata në mbi 45 lumenj. Ne kërkuam që të jemi partnerë në këtë çështje, sidomos në informimin e publikut. E njëjta gjë po ndodh edhe në Shqipëri. Kjo është një trashëgimi e përbashkët dhe një çështje e përbashkët. Unë besoj se kjo rezolutë dhe PE-së, por edhe Komuniteti i Energjisë, të cilët theksojnë, se komunitetet lokale duhet të përfshihen në të gjitha këto procese dhe praktikisht ato duhet të ftohen për shumë çështje të tilla. Rishikimi i kontratave në administrimin e tyre, pra sikur disa nga këto të mos ndërtohen për këto 10 vjetët e fundit, pra që kontratat janë akoma të vlefshme, disa nga ato duhet të ndërpriten dhe disa të tjera të rishikohen nga e para.

Reagimi i EkoAkcija (Bosnje-Hercegovina).

Si në Shqipëri, ne nuk kemi zona të mbrojtura. Ky është një problem i politikës sonë. Korrupsioni ka ndikuar që çdo gjë të shitet. Fatkeqësisht BE-ja nuk po ndihmon sa duhet, që kur vendi po menaxhohet nga ndërkombëtarët. Ne po shkatërrojmë lumenjtë shumë shpejt. Gjendja është më keq se 15 vjet më parë. E njëjtë situatë është në rajon. Na duhet një strategji për këto vende.

Reagimi i Shoqatës TOKA - për mbrojtjen e Alpeve shqiptare.

Shumë zona të veriut janë prekur nga shkatërrimet. 95 për qind e të pyeturve i duan zonat e mbrojtura. Ata mendojnë njësoj dhe kanë të drejtë. Ata duan të mbrojnë shtëpitë e tyre. Ky është një komunitet që kërkon vëmendje. Ne duhet të ndihmojmë njëri-tjetrin. BE-ja duhet të jetë e vëmendshme ndaj kësaj padrejtësie. Ata besojnë në informimin e drejtë dhe të shpeshtë. Banorët duan një të ardhme të ndritur, por tani kemi një ngërç. Ata po dënohen sepse po flasim për natyrën. Ajo po ndikon në jetën e tyre. Dokumentet tona janë të vlefshme. E drejta për informim dhe pjesëmarrje. E drejta për të pasur një të ardhme për zhvillimin e natyrës. Reagimi ynë tregon posaçërisht se çfarë po ndodh me popullsinë lokale në Valbonë. Shumë në Shqipëri nuk e dinë as ku janë parqet kombëtare, sepse nuk kanë të dhëna për to. Por tani ju shikoni se parqet kombëtare janë tonat dhe duhet të mbrohen nga ne.

Reagimi kreut të sektorit të Qendrës për Ekspertizë Tematike në Ndërlidhje, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal, pranë Komisionit Evropian.

Prodhimi i energjisë elektrike nga HEC-të do të luajë një rol kyç në zhvillimin e ekonomive të Shqipërisë dhe pjesës tjetër të Ballkanit Perëndimor. Nëse shikojmë me kujdes, në Ballkan, gjysma e energjisë elektrike vjen nga HEC-të, por gjysma tjetër vjen nga centralele me energji termike. Kështu rezistenca, ndaj zhvillimit të projekteve hidrike, duhet të marrë parasysh edhe nevojën që ka rajoni për energji elektrike, si një mjet për të mbështetur ekonominë. Kjo formë e energjisë, së bashku me energjitë e tjera të rinovueshme, janë alternativat e duhura përballë centraleve që krijojnë ndotje.

Kërkesa për energji në Ballkan është e lidhur me rritjen ekonomike dhe me plot gjasa, pasi sasia e energjisë së ofruar tani nuk do të jetë e mjaftueshme për të ardhmen. Argumenti i kontributit në ekonomi mbështetet edhe nga rasti i Shqipërisë. Të dhënat e Institutit të Statistikave tregojnë se prodhimi i energjisë elektrike mbajti peshën kryesore në rritjen ekonomike prej 4.3% të vendit. Gjithashtu, të dhënat e prodhimit të energjisë në vend, nga prodhuesit e HEC-ve private zënë tashmë 1/3 e prodhimit në shkallë vendi.

Është bërë një studim të sektorit të energjisë, pas kërkesës së vendeve të Ballkanit, për të hartuar një strategji për zhvillimin e këtij sektori. Dolem me disa parime thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë hidrike, që përfshijnë disponueshmërinë e ujit, impaktin e ndryshimit klimatik, angazhimin e komuniteteve lokale, analizimin e saktë të ndikimit mjedisor dh social, si dhe planifikimin e gjerë, përmes direktivave dhe planeve për menaxhimin e lumenjve, jo për 2500 projekte HEC-esh të vogla një më një, por duhet të kemi një përqasje më të përgjithshme. Qëndrimi ynë për HEC-et e vegjël është i qartë. Në qendër duhet të jetë konsultimi me komunitetet lokale. Edhe sipërmarrjet duhet të përpiqen të gjejnë zgjidhje dhe të dëgjojnë zërin e komuniteteve lokale.

Mbi këto rekomandime bazohet edhe platforma e Konfindustrisë Shqiptare, për përballjen me problematikat mjedisore të ndërtimit të HEC-ve në realitetin e Shqipërisë. Ndër të tjera platforma vë theksin në veprimet e menjëhershme dhe masat afatgjata që propozohen, si kontrollin e përhershëm profesional nga agjencitë shtetërore të zbatimit të kushteve të gjithë kontratave koncesionare në zbatim ku ka filluar investimi fizik në terren dhe pasqyrimin në një sistem publik baze të dhënash/data base; përmirësimi i legjislacionit mjedisor në fuqi; eliminimin e ofertave të pakërkua; ndërtimin e planeve urbanistike, sipas standardeve ndërkombëtare për të gjithë zonat e mbrojtura dhe ato me potencial zhvillimi turistik; krijimin e një ministrie të posaçme për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe optimizimin e fushatave ndërgjegjësuese.

Sipas diplomatit të Misionit të Shqipërisë, në BE, nevoja për impiante të reja të prodhimit të energjisë është emergjente, përballë vjetërsisë dhe mungesës

së investimit në strukturat ekzistuese publike. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë burime të larta ujore, që llogariten në rreth 10600 m³për person, që është dyfishi i mesatares evropiane. Duke marrë parasysh kapacitetin e limituar, që mund të arrihet duke përmirësuar strukturat ekzistuese dhe për të përmbushur kërkesat në rritje për energji, duhet të zhvillohen burime të reja përgjatë rajonit. Madje ka një konsensus shkencor, që Ballkani Perëndimor ka nevojë për të dyja, si burime të reja energjie, po ashtu edhe një strategji për zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë hidrike, për të qenë miqësore me mjedisin. Në 10 vitet e fundit, kapaciteti prodhues i vendit është rritur me 35%, pas vendosjes në punë të 93 hidrocentraleve të vogla dhe të mesme, që i përkasin 73 kontratave koncesionare. Megjithatë, mbi 65% e kontratave të lidhura për ndërtimin e HEC-ve nuk janë ende operative për arsye të ndryshme, çka ka shtyrë edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të nisë një proces masiv rishikimi.

Propozimet për të zgjidhur këto problematika të hasura kanë ardhur nga shumë grupe interesi e shoqata, por edhe përmes përpjekjeve të strukturave evropiane.

Reagimi i Grupimit “Të mbrojmë Lumenjtë”.

Përpjekjet e OShC-ve shqiptare janë përqendruar në informimin e komuniteteve lokale dhe organeve vendore mbi vlerat dhe risqet potenciale të ndërtimit të hidrocentraleve, duke publikuar udhëzues për investitorët dhe institucionet shtetërore, duke kryer studime me karakter lokal e kombëtar, zbatuar miniprojekte për ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale, por edhe duke kërkuar në forma dhe mënyra të ndryshme reagimin e organeve shtetërore.

#Rasti i moratoriumit për ndalimin e dhënies së lejeve për koncesione për HEC-et. Kjo nisëm u mbështet nga Fondi Botëror për Jetën e Egër (WWF), por edhe nga organizatat e tjera të vendit, veçanërisht të grupimit “Të Mbrojmë Lumenjtë”, i përbërë nga: INCA, REC Albania, EDEN, Ekolëvizja, EkoAlbania, Mileukontakt Albania, Shoqata e Bujqësisë Organike, ILIRIA, Qendra për Rregullimin dhe Ruajtjen e Energjisë në Shqipëri, Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit, Instituti i Politikave Mjedisore, Lex Ferenda, Shoqata Toka (Valbonë), Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës, etj., të cilët ndërmorën nismën (2015) të moratoriumit për ndalimin e dhënies së lejeve për koncesione për HEC-ve në territorin e Shqipërisë.

#Pasi: Rritja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike është një nga trendet e zhvillimit në mbarë rajonin në ditët e sotme. Sipas raportit të Zhvillimit Botëror të Ujit të Kombeve të Bashkuara, 60% e 227 lumenjve më të mëdha botëror janë të fragmentuar rëndë nga digat, devijimet dhe kanalet e ndërtuara me qëllimin e ndërtimit të HEC-ve apo përdorimit të ujërave të lumenjve në bujqësi, industri apo furnizim me ujë të pijshëm, që çojnë në degradimin e ekosistemeve të cilët luajnë një rol thelbësor në filtrimin dhe

sigurimin e burimeve e ujërave të ëmbla.

Megjithëse kjo mënyrë e prodhimit të energjisë është klasifikuar si burim energjetik i rinovueshëm, një numër marramendës i HEC-ve (rreth 540, burimi AKBN) planifikohet të ndikojnë negativisht në ekosistemet natyrore, duke përfshirë edhe zonat e mbrojtura me vlera të larta, të tilla si parqet kombëtare natyrore. Ndonëse këto zona janë ligjërisht të mbrojtura ndaj zhvillimit të HEC-ve, ka shumë shembuj që janë në punë ose që po ndërtohen në parqet kombëtare (p.sh. në parqet e Shebenik-Jabllanicës, Valbonës, Lurës, Bredhi i Hotovës, Bënçës, Korab-Korintik, Theth, etj.) duke ndikuar negativisht në vlerat natyrore të këtyre zonave deri në degradimin e tyre, vlera që ndikojnë në atraksionin që këto zona ofrojnë dhe në zvogëllimin e vizitorëve të tyre.

Këto çështje të rëndësishme që janë pjesë e planifikimit dhe menaxhimit të integruar të territorit e në veçanti të zonave të mbrojtura natyrore, që tërheqin vëmendjen e të gjithë publikut e në veçanti të atyre që e duan natyrën e bukur shqiptare me vlerat e saj të rralla dhe papërshtueshme, janë tashmë çështje të nxehta kur prishen ekuilibrat natyrorë, kur bëhen burime konfliktesh komunitare, kur ndryshojnë rrjedhën natyrore të lumit apo kur shkatërrojnë një shtat mali a kodre për interesa të ngushta dhe në dëm të zhvillimit të shoqërisë.

Për të realizuar mbrojtjen dhe menaxhimin me kritere pro mjedisore dhe pro zhvillimit të qëndrueshëm, grupimi "Të mbrojmë lumenjtë" ka ndërmarrë nismën për t'i kërkuar moratorium lidhur me ndërtimin e veprave energjetike në lumenjtë e Shqipërisë për një periudhë 3 vjeçare. Moratoriumi kërkohet para së gjithash për ndalimin e dhënies së licencave të koncesioneve për HEC-et në të gjithë territorin e vendit. Ky moratorium do të shërbejë për të analizuar situatën aktuale të koncesioneve dhe kushteve të zbatimit të tyre në përputhje me kërkesat ligjore të zhvillimit të territorit si dhe kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor.

Kjo nismë do të shërbejë në përmirësimin e kuadrit ligjor, zbatimit të praktikave të mira për koncesionet dhe ruajtjen e mjedisit, si dhe për integrimin e konventave dhe direktivave evropiane në dokumentet strategjike kombëtare sikurse janë Strategjia Kombëtare e Ujit, Strategjia Kombëtare e Energjisë, Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe Planct Kombëtare Sektoriale, zbatimi i ligjit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore që është përafrim i direktivës kuadër të ujit të KE-së, etj., dokumente të cilat janë tashmë në fazat e zhvillimit të tyre.

Në mënyrë më specifike gjatë periudhës së moratoriumit do nevojitet të rishikohen, pezullohen dhe anulohen të gjitha licencat e dhëna deri më sot në zonat e mbrojtura dhe zonat sensitive lumore me potenciale të larta natyrore me prani të monumenteve natyrore në to. Rishikimi i veprave hidrike mbi lumin Vjosë, HEC-i i Kalivaçit, Lengaricës dhe Bënçës janë një prioritet,

qëkurse kryeministri i vendit është shprehur për angazhimin qeveritar për ta kthyer lumin Vjosa, në Park Kombëtar. Por jo vetëm mbi lumin Vjosë, pasi ka ende koncesione që janë dhënë dhe nuk janë vënë në zbatim dhe që ndikojnë në zonat e mbrojtura natyrore si në lumin e Valbonës, në zonën e Shebenik-Jabllanicës, në zonën e Korabit, në zonën e malit të Tomorrit, etj.

Askush nuk thotë "JO" për zhvillimin e shoqërisë, për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit, për përdorimin efektiv të burimeve natyrore, por i themi "JO" zhvillimit pa kritere që sjell pasoja katastrofike në mënyrën e menaxhimit të burimeve natyrore.

Reagimi i EcoAlbania – Lumi i Vjosës.

#PETICION "Për mbrojtjen e Lumit Vjosë"

Lumi Vjosa është një ndër lumenjtë e fundit në gjendje natyrore në Evropë. Për më shumë se 270 km ai rrjedh i paprekur dhe i pandërprerë. Lumi është i karakterizuar nga kanione të bukur, në rrjedhën e sipërme dhe ka një shtrat të gjerë e madhështor në rrjedhën e mesme e të poshtme. Së bashku me degët e saj, Vjosa krijon një ekosistem dinamik, një trashëgimi të vërtetë të natyrës evropiane. Në të njëjtën kohë, Vjosa është një nga lumenjtë më paktë njohur të Evropës. Të dhënat ekologjike dhe hidro-morfologjike për të janë jashtëzakonisht të kufizuara.

Megjithatë, në pellgun ujëmbledhës të Vjosës, janë parashikuar të ndërtohen rreth 34 HEC-e, 9 prej të cilëve mbi rrjedhën kryesore të saj. Çelja e procedurave të tenderimit për HEC-in e Poçemit përbën aktualisht një ndër kërcënimet më të mëdha. Ndërhyrja e pabazuar në studimet e thelluara për ndërtim hidrocentralesh edhe në degët e Vjosës (si në: Lengaricë, Bënçë, Shushicë, etj.) vë gjithashtu në pikëpyetje ekzistencën e lumit të fundit të "egër" në Evropë. Ndërkohë institucionet e BE-së janë shprehur qartë në Rezolutën e Parlamentit Evropian të vitit 2014, konkretisht në pikën 27 të saj, ku evidentohet rëndësia e veçantë që ka mbrojtja e lumit Vjosa, si një trashëgimi natyrore Evropiane.

Një kërcënim tjetër për këtë pellg ujëmbledhës është edhe Plani Grek i Menaxhimit, miratuar nga Qeveria Greke, ku parashikohet devijimi i një sasive të ujërave të lumit Vjosa drejt liqenit të Janinës. Projekte të tilla do ta shkatërrojnë këtë ekosistem lumor unik. Për më tepër, këto projekte bien ndesh me legjislacionin e BE-së si Direktiva e Zogjve, Direktiva e Habitaveve dhe Direktiva Kuadër e Ujërave.

Ne, OJF-të shqiptare të grupimit "Të shpëtojmë Vjosën", kundërshtojmë fuqimisht projektet që cenojnë integritetin e lumit të Vjosës. Ne, duam të mbrojmë këtë thesar të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe socio-historike të rajonit.

Ne kërkojmë, që Qeveria Shqiptare të ndalojë projekte të ndërtimit të HEC-ve

në gjithë luginën e Vjosës si dhe të angazhohet në shpalljen e saj Park Kombëtar. Vjosa duhet të mbrohet në të gjithë gjatësinë e saj, sepse ndërtimi i qoftë dhe një digë të vetme do ta shkatërronte përfundimisht këtë ekosistem unik dhe do t'i jepte fund vizionit të Parkut Kombëtar të parë të një lumi natyror në të gjithë Evropën.

#Ndryshime në ligjin e koncesionit. Një grup organizatash të shoqërisë civile kanë reaguuar (15 mars 2019) në lidhje me mos miratimin e disa propozimeve për ndryshime në ligjin për koncesionet. Me një angazhim mbledhës për njëvjeçar me mbështetjen e Lëvizjes Albania, organizata EcoAlbania, në bashkëpunim me organizata mjedisore kombëtare dhe lokale, ekspertë të ligjit e mjedisit, ka ndërmarrë nismën për ndryshime në paketën ligjore të koncesioneve për HEC-et. Pas konsultimeve me aktorë të shumtë, në fillim të muajit shkurt, të këtij viti, u dërguan propozimet për shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, pranë komisioneve parlamentare përgjegjëse për shqyrtimin e projektligjit.

Analiza u diskutua në një seancë të veçantë, në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, ku disa prej pikave të propozuara u morën në konsideratë. Komisioni miratoi propozimet lidhur me identifikimin e projekteve koncesionare, duke u mbështetur në planet dhe strategjitë kombëtare si dhe disa detajime lidhur me studimin e fizibilitetit. Megjithatë, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, si komision përgjegjës, nuk miratoi asnjë prej tyre, duke mos dhënë asnjë argument konkret.

Disa prej propozimeve kryesore janë:

1. Heqja e propozimeve të pakërkuara si një praktikë tejet e përhapur, e cila nuk garanton cilësi në studimin e fizibilitetit si dhe konkurrencë të drejtë.
2. Identifikimi i projekteve të mundshme koncesionare/PPP duhet të bëhet duke u mbështetur në strategjitë, planet apo programet sektoriale e ndërsektoriale të nivelit kombëtar, vendor e ndërvendor.
3. Detajimi i studimit të fizibilitetit, duke ezauruar të gjitha pjesët që ai duhet të përmbajë si pjesë përbërëse të tij, si: analizën teknike, analizën ekonomike e financiare dhe ndikimet mjedisore e sociale.
4. Përfshirja në tarifën e koncesionit, e pagesës për shfrytëzimin e pasurisë në pronësi të shtetit dhe/ose personave privatë.

OSHc-të theksuan edhe njëherë se situata e HEC-ve në Shqipëri është alarmante, pasi janë planifikuar më shumë se 540 hidrocentrale në gjithë territorin e Shqipërisë. Një pjesë e konsiderueshme e të cilëve (rreth 39%) në zona të mbrojtura dhe zona me potencial të lartë natyror si lumi Vjosë dhe degët e tij.

Për këto shqetësime të vazhdueshme është ndjekur rruga ligjore për të kundërshtuar projektet e HEC-ve në luginën e Vjosës, Valbonës, Rapunit, Thethit, Tomorrit, Lengaricës, Osumit, etj. e megjithatë mendojmë se kjo do të ishte një betejë pafund pasi legjislacioni aktual favorizon dhënien e lejeve të reja pa zbatuar standardet më të larta për ruajtjen e mjedisit. Ndaj mendojmë së disa prej rekomandimeve e paraqitura do të ndryshonin këtë situatë në të mirë të natyrës dhe komuniteteve lokale.

Kjo nisëm përkon me skanimin e kontratave koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve, që ka nisur së fundmi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Ndryshimet ligjore të propozuara do të zgjidhnin ngërçet dhe boshllëqet ligjore për këto koncesione, duke evituar më pas edhe procese skanimesh të panevojshme në të ardhmen. EcoAlbania dhe OShC-të do të vijojë përpjekjet për përcjelljen e zërit të ekspertëve, përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe banorëve të prekur nga zhvillimi i projekteve dhe në organet ndërkombëtare dhe në PE.

MJETET E PËRDORURA:

- Strategjia e hartuar për Rrjetin e Mbrojtjes së Natyrës për një përfaqje strategjike në adresimin afatgjatë të problematikës dhe të nevojave të ngritjes dhe zhvillimit të një sistemi për identifikimin e çështjeve kryesore me të cilat përballen Zona të Mbrojtura Mjedisore (ZMM).
- Broshurat: "Legjislacioni bazë dhe mbështetës mjedisore për menaxhimin e zonave të mbrojtura" dhe "Vlerësimi i gjendjes së problematikave mjedisore dhe të zonave të mbrojtura në Shqipëri".
- Metodologjia (*nëpërmjet pyetësorit-individual*), për realizimin e identifikimit, vlerësimin, analizimit dhe të hartografimit të impakteve negative në ZMM, mjet efektiv për të arritur tek qytetarët dhe/apo banorët që jetojnë në afërsi të ZMM-ve.
- Takime dhe investigime të organizuara me përfaqësues komuniteteve, kryeploqtë, administratorët e njësive administrative, të bizneseve, shkollat, OJF-ve mjedisore, administratat vendore dhe të AdRZM-ve, etj. për vlerësimin e situatës aktual, të problemeve ekzistuese dhe potenciale në zonën e mbrojtur, të cilat kanë ndikim në biodiversitet, ekosisteme, peizazhe, burimet natyrore dhe në zhvillimin vendor social-ekonomik.
- Raportet e Gjendjes në Mjedis, të AKM.
- Planet e menaxhimit të ZMM, AKZM.
- Konferenca për shtyp në lidhje me HEC-et - Grupimi "Të mbrojmë lumenjtë", më datë 16.07.2015, organizoj një konferencë për shtyp për të realizuar mbrojtjen dhe menaxhimin me kritere pro mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm ndërmori nismën për t'i kërkuar moratorium, lidhur me

ndalimin e ndërtimit të veprave energjetike në lumenjtë e Shqipërisë, për një periudhë 3 vjeçare.

- Takime në Parlament, me deputetë dhe në komisione.
- Takim me përfaqësues nga UNDP, OSBE, REC, AKZM, si dhe të grupimit #“Të mbrojmë lumenjtë”.
- Reagime nga mjaft deputet të Parlamentit shqiptar, të cilët kanë denoncuar veprimet dhe vendime e marra haptazi (të shkruara dhe të tanishme) që janë tërësisht në dëm të interesit publik (duke i cituar dhe si babëzi të madhe) ndaj planit për ndërtimin e HEC-ve.
- Dërgim të letrave -Drejtorit të Përgjithshëm, në Drejtoria e Përgjithshme për Mjedisin, Komisioni Evropian; Drejtorit të Përgjithshëm, Komisioni Evropian, në Drejtorinë e Fqinjësisë dhe të Negociatave të Zgjerimit; Kryetarit të Delegacionit të Bashkimit Evropian, në Shqipëri; Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Shqipëri; Prezencës së OSBE, në Shqipëri; Koordinatorit të përhershëm të OKB-së në Shqipëri dhe përfaqësues i përhershëm i UNDP; Organizmave të tjerë joqeveritare ndërkombëtare.
- Rezoluta e Parlamentit Evropian, më 14 prill 2016, në Raportin për Shqipërinë, bën thirrje qeverisë shqiptare për të kontrolluar zhvillimin e hidrocentraleve në zona të ndjeshme mjedisore të tilla si rreth lumit Vjosa dhe në zonat e mbrojtura.
- Konferenca e 7 Marsit 2019, në Parlamentin Evropian, me titullin “Ruajtja e lumenjve të Ballkanit - Rezistenca ndaj hidrocentraleve në Ballkan dhe Shqipëri”.
- Kërkesa drejtuar Kryeministrit dhe ministrive të linjës, nga një grup të OShC-ve shqiptare.
- Konferenca e Kryeministrit dhe e 2 Ministrave për HEC-et, në takimin “Zhvillimi i burimeve natyrore në harmoni me mjedisin”u theksua: Dy momente me rëndësi themelore që janë adresuar në këtë periudhë kanë pasur të bëjnë me minierat dhe me HEC-et, për të krijuar një ekuilibër sa më të natyrshëm mes nevojës së pandalshme për zhvillimin dhe domosdoshmërisë që zhvillimi të mos cenojë të ardhmen e vendit dhe të mos ndodhë në kurriz të gjeneratave të tjera.
- Bashkëbisedime me pushtetin vendor dhe komunitetin.- Bashkëbisedim dhe Informimin në Një Shoqëri Demokratike” organizuar nga shoqata “TOKA”- Në këtë bashkëbisedim morri pjesë ambasadori i SHBA, përfaqësuesi i Delegacionit të BE-s në Tiranë, etj, dhe u vu re mungesa nga drejtuesit kryesor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe ata të Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Ambasada e Gjermanisë, ka mbështetur publikisht banorët e zonës së Valbonës, për pezullimin e punimeve për ndërtimin e hidrocentraleve në parkun kombëtar të Valbonës. Reagime të tilla ka pasur edhe nga ambasada të tjera të akredituara në Tiranë.
- Prezenca e OSBE, në Shqipëri ka organizuar një takim pune "Sesion dëgjese për zhvillimin e hidroenergjisë në Shqipëri". Në këtë takim u diskutuan rastet: Parkut Kombëtar i Valbonës, Parkut Kombëtar "Shebenik-Jabllanicë", rasti i Lumit Vjosë etj.
- Parlamenti Evropian i ka kërkuar qeverisë shqiptare të rishikojë projektet hidroenergjetike përgjatë lumit Vjosa dhe degëve të këtij lumi dhe të hartojë Planet e Ndikimit në Mjedis, përpara se projektet të vihen në zbatim.
- Organizime të fushatave dhe protestave.-Për hidrocentralet në Lumin Vjosa, për të luftuar këtë valë shkatërrimi, EuroNatur, RiverWatch, EcoAlbania dhe grupimi #“Të shpëtojmë lumenjtë”.
- Organizimi i fushatës #“Të Shpëtojmë zemrën blu të Evropës”. Kundër këtyre HEC-ve janë ngritur dhe disa drejtues të pushtetit vendor, të cilët thonë se projektet energjetike nuk janë konsultuar me komunitetin dhe prekin rëndë interesat e tyre. Protesta të fuqishme janë bërë për Vjosën, Langaricën, Bençën, Poçemin, Valbonën, Shebenikun, Lumën, Korabin, kanionet e Dsumit, etj. Kundërshti ndaj HEC-ve kanë edhe banorët, të cilët thonë se projektet nuk janë konsultuar me komunitetin dhe rrezikojnë të ardhurat e tyre të bazuara tek turizmi malor. Në këto protesta janë bashkuar edhe aktivistë mjedisorë, personalitete të të gjitha fushave, shqiptarë që kanë emigruar dhe turistë e agjenci turistike nga mbarë bota, që e kanë futur udhëtimin në ZMM-re si një prej destinacioneve të tyre kryesore.
- Protesta e zhvilluar në Tropojë me moton #“MosMaPrekValbonën” - të tilla protesta janë zhvilluar edhe në Tiranë përpara ministrisë së Energjetikës dhe Kryeministrisë, ku është kërkuar anulimin e lejeve të HEC-ve në parkun kombëtar të Valbonës.
- PNUD: “149 HEC-e po minojnë zonat e mbrojtura”, 2018. Një studim në terren i 20 ekspertëve,nga PNUD,ka vërejtur një situatë alarmante në të gjithë procesin që shoqëron ndërtimin e HEC-ve që nga momenti i dhënies së lejeve, planifikimit dhe ndërtimit. Dëmet më të mëdha janë bërë në zonat e mbrojtura, pasi aty dendësia e lumenjve dhe ujërave është e madhe. Në zonat e mbrojtura aktualisht kanë përfunduar punimet dhe janë në operim 26 HEC-e, 16 të tjera janë në proces ndërtimi dhe 105 të tjera kanë marrë lejen. Sakaq inspektimi në HEC-et e përfunduara, i pari i këtij lloji nga një ekspertizë e pavarur ka gjetur se pjesa e dërrmuese e objekteve janë ndërtuar pa respektuar standardet mjedisore dhe ato për mbrojtjen e faunës. Kushtet për vendkalimin e peshqve nuk janë marrë në

konsiderate dhe kriteret për rehabilitimin e mbeturinave dhe rivitalizimin e zonës pas punimeve nuk janë bërë.

- Gjithashtu ekspertet vërtetuan se Ministria e Energjetikës gjatë dhënies së lejeve nuk ka marrë në konsideratë ligjet e tjera në fuqi për mbrojtën e mjedisit dhe zonave të mbrojtura. U verifikuan se Shqipëria ka shkelur edhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit që i ka nënshkruar. Sipas tyre lejet për ndërtimin e HEC-ve janë dhënë pa analizën kosto-përfitim, por të shtyra nga logjika e plotësimit të kërkesës për energji dhe nevojës për të hapur fronte të reja për biznes.
- Në përfundim të kërkimeve ata kanë formuluar rreth 30 rekomandime, të cilat ia ka vënë në dispozicion Ministrisë së Energjetikës për të përmirësuar sado pak situatën. Ekspertët kërkojnë që të mos ndërtohet asnjë HEC tjetër në zonat e mbrojtura. Nga verifikimet në terren ata gjetën se, pothuajse të gjitha HEC-et kanë krijuar erozion dhe në të ardhmen pritet të sjellin kosto të mëdha financiare në buxhetin e shtetit për të menaxhuar pasojat negative në vijimësi.
